# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5589
E shtunë, 29 shtator 2018
çmimi 0.40 €

## Haradinaj: Pentagoni përkrah ushtrinë dhe popullin e Kosovës

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ISMET SALIHU FAQE 4-5

# S'mund të nxirren para drejtësisë 20 mijë persona



Profesori i së Drejtës Penale, Ismet Salihu, ka vlerësuar se shteti i Kosovës duhet të veprojë me pragmatizëm sa i përket çështjes së veteranëve të UÇK-së. Ai ka thënë se ky proces patjetër duhet të ndriçohet deri në fund. Sipas Salihut, duhet të gjendet një solucion i cili do ta vë drejtësinë në vend. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se procesi i hetimit të veteranëve duhet të realizohet nga qendra dhe jo nëpër gjykata themelore. Salihu ka thënë se shpërndarja nëpër gjykata do ta bënte këtë çështje pazari. Ai ka bërë me dije se do të jetë e pamundur që 20 mijë persona të nxirren para drejtësisë

PRESIDENTI I VENDIT, HASHIM THAÇI, KA MBAJTUR TË PREMTEN KONFERENCË PËR MEDIE PAS KTHIMIT NGA NJU JORKU FAQE 3

# Thaçi: Të flasim me një zë për vizat ose procesi shtyhet deri në 2020-n

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka bërë thirrje gjithë spektrit politik që të flasë me një zë para zyrtarëve të BE-së për liberalizim të vizave. Pas kthimit nga Nju Jorku, ai ka bërë me dije se nëse nuk prezantohet nga të



gjithë progresi i arritur në këtë proces, liberalizimi i vizave mund të shtyhet deri në vitin 2020. Sipas shefit të shtetit, nëse pozita dhe opozita paraqiten të bashkuara në këtë proces, liberalizimi i vizave përmbyllet në muajt e ardhshëm




## 77.6 për qind e qytetarëve kundër idesë së shkëmbimit të territorit me Serbinë

FAQE 5

## AKTUALE

RRITET NUMRI I PERSONAVE ME SËMUNDJE TË ZEMRËS F. 7

SOT MBAHET PROTESTA E VETËVENDOSJES, POLICIA NDËRMERR MASA PËR TA MBIKËQYRUR F. 7

IMPLEMENTIMI I STRATEGJIVE MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE, SFIDË PËR KOSOVËN F. 7

## EKONOMI

BRUTO PRODUKTI VENDOR SHËNOI RRITJE PËR 4.7 PËR QIND F. 8

BIZNESET ITALIANE, RUMUNE DHE BULLGARE KËRKOJNË TREG NË KOSOVË F. 8

## KULTURË

MINISTRI BYTYQI VIZITOI BIBLIOTEKËN E KONGRESIT AMERIKAN F. 13

## SPORT

VËMENDJA ZHVENDOSET NË GJILAN, PARALAJMËROHET NJË DERB I JASHTËZAKONSHËM F. 18

MKRS-ja, DY MILIONË EURO PËR KATËR PROJEKTE NË RAHOVEC F. 18

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Meta: NATO-ja dhe BE-ja, garancia më e mirë për Ballkanin

NJU JORK, 28 SHTATOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, mbajti të premten fjalimin para Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Meta përshëndeti marrëveshjen në mes të Maqedonisë dhe Greqisë si një zhvillim pozitiv për stabilitetin e Ballkanit që, siç u shpreh ai, i ka të gjitha shanset të bëhet një marrëveshje historike.

Presidenti Meta bëri thirrje gjatë fjalimit të tij në OKB për miratimin e referendumit të së dielës në Maqedoni për ndryshimin e emrit. "Ne u kemi bërë thirrje të gjithë aktorëve politikë në Maqedoni, përfshirë udhëheqësit lokalë shqiptarë, që të angazhohen në mënyrë aktive për suksesin e referendumit të 30 shtatorit, duke mbështetur një votë në favor të marrëveshjes", tha Meta.

Presidenti i Shqipërisë tha se në kushtet kur në Ballkan vazhdojnë proceset për paqen dhe integrimin, Shqipëria beson se çdo marrëveshje dypalëshe e arritur mes vendeve ballkanike kontribuon drejtpërdrejt te paqja, siguria, qëndrueshmëria dhe zhvillimi ekonomik. Ai tha se marrëveshja e arritur kohët e fundit në mes të Greqisë dhe Maqedonisë i ka të gjitha mundësitë të bëhet një arritje historike.



Meta tha se përkushtimi ndaj NATO-s dhe BE-së janë garancia më e mirë për të gjitha vendet dhe qytetarët e rajonit të Ballkanit. Ai tha se kushtet aktuale favorizojnë përparimin e mëtejshëm të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e BE-së, duke shtuar se është shumë e rëndësishme që marrëveshja mes të dy vendeve të mishërojë energji pozitive, mbështetjen e vlerave evropiane të bashkëjetesës dhe harmonisë ndëretnike. "Është shumë e rëndësishme që kjo marrëveshje t'i qëndrojë larg historisë të së kaluarës dhe ta përmirësojë jetën e përditshme të qytetarëve të të dyja vendeve. Le të mbajmë parasysh të shkuarën historike të Ballkanit, që ka të bëjë me ndryshime famëkeqe të kufijve, spastrimin etnik dhe zhvendosjet e dhunshme masive", tha Meta.

# Haradinaj: Pentagoni përkrah ushtrinë dhe popullin e Kosovës

**Në takimin me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, sekretari amerikan i Mbrojtjes, James Mattis, ka shprehur konsideratat më të larta për popullin e Kosovës dhe mbështetjen e fuqishme për FSK-në dhe procesin e ndërlidhur me transformimin e kësaj force konform planit strategjik të paraparë**



PRISHTINË, 28 SHTATOR - Në takimin me krerët më të lartë të Departamentit të Mbrojtjes, kryeministri Haradinaj ritheksoi se Ushtria e Kosovës do të jetë garanci e paqes në vend dhe rajon, shumetnike dhe e gatshme për të shërbyer krah Ushtrisë amerikane në misione paqësore në botë. Haradinaj e ka njoftuar sekretarin James Mattis për të gjitha të arriturat e vendit, në veçanti për procesin e nisur të transformimit të FSK-së në Ushtri të Kosovës.

"Të rinjtë tanë nga FSK-ja kanë pasur fatin të mësojnë nga profesionistët më të mirë të Ushtrisë amerikane përmes programeve që na janë ofruar përgjatë viteve. Kjo përvojë e fituar është baza më e mirë që e kemi për transformimin e FSK-së dhe Kosova është e gatshme për këtë etapë", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se Qeveria e vendit është e fokusuar ta vazhdojë partneritetin me Pentagonin dhe Uashingtonin zyrtar dhe ka kërkuar nga sekretari Mattis përkrahjen e tij për anëtarësimin e Kosovës në mekanizmat e sigurisë dhe në NATO. "Aleatët më të mirë të Kosovës në kohë krize dhe në kohë paqeje kanë qenë dhe janë ShBA-të. Ajo që kanë bërë ushtarët amerikanë, duke shërbyer në Kosovë, është vepër për të cilën ne ndihemi krenarë, për të cilën ju duhet të ndiheni krenarë", ka shtuar Haradinaj.

Kryeministri Haradinaj e ka informuar sekretarin e Mbrojtjes, Mattis, se Kosova është e gatshme ta përmbyllë procesin e dialogut me Serbinë dhe ta përfundojë konsolidimin e brendshëm dhe të jashtëm të vendit.

Ndërsa sekretari Mattis ka shprehur konsideratat më të larta për popullin e Kosovës, të kaluarën e saj dhe aspiratat për të jetuar të lirë si pjesë e familjes euroatlantike.

Sekretari Mattis ka shprehur gatishmërinë dhe përkushtimin e Qeverisë amerikane për ta ndihmuar Kosovën në procesin e dialogut, por edhe në të gjitha proceset nëpër të cilat po kalon Kosova. Në këtë kontekst, sekretari Mattis ka konfirmuar edhe një herë mbështetjen e fuqishme për FSK-në dhe procesin e ndërlidhur me transformimin e kësaj force konform planit strategjik të paraparë.

Në këtë plan sekretari Mattis ka konfirmuar se ShBA-ja do të punojë ngushtë për implementimin e secilës etapë të këtij plani.

Pritja zyrtare me nderime ushtarake në Pentagon nga sekretari i Mbrojtjes, James Mattis, është një nga takimet e posaçme në kuadër vizitës zyrtare që kryeministri Haradinaj është duke e zhvilluar në ShBA.

## Hahn: Shqipëria, në rrugë të mbarë

BRUKSEL, 28 SHTATOR - Procesi screening që sapo ka nisur në Bruksel, përfaqëson hapin e parë drejt përgatitjes për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Komisionari për Zgjerim në BE, Johannes Hahn, përshëndeti nisjen e procesit në një konferencë të përbashkët për shtyp me ministren e Drejtësisë, Etilda Gjonaj dhe zëvendëskryeminsitrin dhe ministrin për Punë të Jashtme të Maqedonisë, Bujar Osmani, duke theksuar se kjo javë shënoi "takimin e parë në kuadrin e një sërë takimesh që kanë për qëllim transpozimin e legjislacionit. "Mesazhi im për delegacionet dhe qytetarët e vendeve tuaja është se puna tashmë ka filluar. Perspektiva e anëtarësimit në BE do të bëhet realitet, që do të thotë se është bërë shumë punë dhe ka ende shumë punë për të bërë. Theksin vazhdojmë ta vëmë te shteti i së drejtës, i cili është shumë i rëndësishëm", tha Hahni. "Kemi hartuar një udhërrëfyes tejet ambicioz, i cili përgatit terrenin për punën që pritet të bëhet nga sot deri në shtatorin e ardhshëm. Kjo do të thotë se duhet t'i rishikojmë 160 000 faqe të legjislacionit. Ky screening shpjegues, ashtu siç e quani ju, përfaqëson hapin e parë drejt përgatitjes për hapjen e negociatave të anëtarësimit", tha Hahni.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka mbajtur të premten konferencë për medie pas kthimit nga Nju Jorku

# Thaçi: Të flasim me një zë për vizat ose procesi shtyhet deri në 2020-n

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka bërë thirrje gjithë spektrit politik që të flasë me një zë para zyrtarëve të BE-së për liberalizim të vizave. Pas kthimit nga Nju Jorku, ai ka bërë me dije se nëse nuk prezantohet nga të gjithë progresi i arritur në këtë proces, liberalizimi i vizave mund të shtyhet deri në vitin 2020. Sipas shefit të shtetit, nëse pozita dhe opozita paraqiten të bashkuara në këtë proces, liberalizimi i vizave përmbyllet në muajt e ardhshëm



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka ftuar partitë politike të flasin me një zë për procesin e liberalizimit të vizave. Pas kthimit nga Nju Jorku, ku ka marrë pjesë në punimet vjetore të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, presidenti Thaçi ka deklaruar se partitë politike nuk duhet të paraqesin mendime të ndryshme para zyrtarëve të BE-së, por duhet të dalin me qëndrim unik që Kosova i ka përmbushur kriteret, në mënyrë që procesi të mos rrezikohet edhe për dy apo tri vjet të tjera. "Thërras të gjithë politikanët dhe partitë politike që në vend të kemi një kontinuitet, një qëndrim të përgjithshëm dhe të disiplinuar që me një zë të flasim për domosdoshmërinë e arritjes së liberalizimit të vizave në një afat sa më të shkurtër kohor prej disa muajsh", ka thënë Thaçi.

Ai ka treguar se edhe në takimet në Nju Jork që ka pasur me zyrtarët më të lartë të BE-së ka marrë një mesazh të qartë për këtë proces. "Në takimet që kam pasur në Nju Jork me zyrtarët e BE-së kemi marrë porosi shumë të qarta dhe nënvizoj: Nëse ne si politikë e Kosovës, si institucione të Kosovës, nuk do të jemi të bashkuar për këtë temë, për liberalizim të vizave dhe të argumentojmë qartë plotësimin e të gjitha kritereve që kemi arritur deri më tani dhe ta mbrojmë suksesin e Kosovës në takimet me ndërkombëtarët, nëse ndodh e kundërta, atëherë ne i rrezikojmë këto arritura, apo që gjithë procesi të shtyhet për vitin 2020. Por, nëse jemi të bashkuar dhe prezantojmë progresin dhe suksesin, atëherë kjo e arritur rezulton e përmbyllur në muajt e ardhshëm", ka thënë presidenti, duke ftuar spektrin politik ta mbrojë progresin e arritur në këtë proces. "Prandaj, ftoj të gjithë të ngrihen mbi çdo interes individual, grupor apo partiak, të gjithë ta prezantojmë progresin dhe suksesin, sepse suksesi dhe progresi është meritë e të gjithëve. Liberalizimi i vizave ndodh për të gjithë qytetarët, jo për ndonjë adresë politike", është shprehur ai.

Askush prej subjekteve politike, ka thënë Thaçi, nuk mund ta rrezikojë procesin e liberalizimit të vizave. "Askush prej nesh që jemi në ballë të shtetit të Kosovës, që e bëjmë politikën në Kosovë, nuk ka të drejtë ta rrezikojë liberalizmin e vizave për qytetarët e Kosovës. Është koha e fundit që të jemi unik për arritjen liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Liberalizimi i vizave është meritë e të gjithë njerëzve, e spektrit politik dhe se nga ky proces nuk do të mund të përfitojë më pak ose më shumë", ka theksuar Thaçi.

## SHBA-ja dhe BE-ja mbështesin arritjen e marrëveshjes Kosovë - Serbi

Në këtë konferencë shefi i shtetit ka bërë me dije se gjatë qëndrimit në Nju Jork ka marrë bekimin e plotë amerikan dhe të BE-së për marrëveshjen finale me Serbinë në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me të. "ShBA-ja i ka dhënë mbështetje të plotë dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke i dhënë mbështetje e të plotë arritjes së një marrëveshje - njohjeje reciproke, përshpejtim të Kosovës drejt NATO-s dhe BE-së", ka thënë ai. Sipas Thaçit, marrëveshja me Serbinë do ta garantojë njohjen reciproke, demarkacionin e kufirit dhe anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare. "Nuk do të ketë as shkëmbim, as ndarje dhe as asociacion me elemente konstitutive", ka deklaruar Thaçi.

Më tutje, ai ka treguar se në takimet e Asamblesë së Përgjithshme ka pasur aktivitet të ngjeshur për anëtarësimin e Kosovës në Interpol, duke shprehur optimizëm se Kosova se do të bëhet pjesë e kësaj organizate. Po ashtu, presidenti Thaçi ka folur edhe për transferimin e FSK-së. Ai është shprehur i bindur se transformimi i FSK-së në Forca të Armatosura po hyn në fazën e fundit. Sipas Thaçit, aktualisht Kosova ka mbështetjen e NATO-s dhe të ShBA-së që, pas miratimit të tri ligjeve përkatëse, FSK-ja të transformohet në Forca të Armatosura të Kosovës. "Jam i sigurt se Forcat e Armatosura të Kosovës do të jenë krenaria jonë dhe kontribuuese të paqes në Kosovë dhe rajon", ka deklaruar presidenti i vendit.

# Jep betimin gjenerata e re e kadetëve të FSK-së

PRISHTINË, 28 SHTATOR (ER) - Në një ceremoni zyrtare, të premten në Kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Prishtinë, kadetët e rinj, që do të studiojnë në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së, dhanë betimin e kadetit.

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, ka përgëzuar kadetët e rinj për fillimin e vitit akademik dhe i ka uruar ata për betimin e kadetit. Berisha ka vlerësuar lart përzgjedhjen e tyre për t'i shërbyer vendit. "Vendimi juaj për t'u bërë pjesë e FSK-së është një vendim i drejtë sepse nuk ka mision më të shenjtë sesa t'i shërbejmë dhe të kontribuojmë për vlerat e lirisë dhe për sigurinë e vendit tonë", ka thënë Berisha.

Në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së këtë vit me konkurs të hapur janë përzgjedhur 16 kadetë, prej tyre dy kadetë të gjinisë femërore dhe një kadet nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.



Flet për "Epokën e re", Ismet Salihu

# S'mund të nxirren para drejtësisë 20



**Profesori i së Drejtës Penale, Ismet Salihu, ka vlerësuar se shteti i Kosovës duhet të veprojë me pragmatizëm sa i përket çështjes së veteranëve të UÇK-së. Ai ka thënë se ky proces patjetër duhet të ndriçohet deri në fund. Sipas Salihut, duhet të gjendet një solucion i cili do ta vë drejtësinë në vend. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se procesi i hetimit të veteranëve duhet të realizohet nga qendra dhe jo nëpër gjykata themelore. Salihu ka thënë se shpërndarja nëpër gjykata do ta bënte këtë çështje pazari. Ai ka bërë me dije se do të jetë e pamundur që 20 mijë persona të nxirren para drejtësisë**

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Profesori i së Drejtës Penale, Ismet Salihu, ka thënë të premten se solucioni më i mirë për zgjidhjen e çështjes së veteranëve të UÇK-së do të ishte ndalja e pensioneve të veteranëve të jashtëligjshëm. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se do të jetë e pamundur që të nxirren para drejtësisë 20 mijë persona por, sipas Salihut, procedura penale duhet të ndiqet ndaj përgjegjësve kryesorë. "Nëse jo 100 për qind, 98 për qind e atyre që janë në evidencë janë veteranë të jashtëligjshëm apo, siç po i quajnë, veteranë të 'rrejshëm'. Pensionet duhet të ndalen, kurse ata kryesorët duhet të nxirren para gjykatës. Veteranëve të 'rrejshëm' si masë e përkohshme duhet t'u ndalet pensioni. Nëse konstatohet se ata kanë marrë kundërligjshëm, duhet të detyrohen t'i kthejnë ato mjete. Përndryshe, 20 mijë persona nuk mund të nxirren para gjykate, mirëpo duhet të nxirren personat kryesorë që i kanë kontribuar kësaj", ka deklaruar ai.

Salihu ka vlerësuar se shteti i Kosovës duhet të veprojë me pragmatizëm sa i përket çështjes së veteranëve të UÇK-së. Sipas tij, procesi i hetimit të veteranëve duhet të realizohet nga qendra dhe jo nëpër gjykata themelore. Salihu ka thënë se shpërndarja nëpër gjykata do ta bënte këtë çështje pazar. "Nuk e di nëse është bërë një gjë e tillë, mirëpo me këtë çështje duhet të merret qendra. As teorikisht e as praktikisht nuk mund të nxirren para gjykatës 20 mijë persona. Nëse duan të kryejnë punë kjo duhet bërë në qendër, pra në një vend, por nëse ndahet në shtatë gjykata themelore në nivel Kosove, kjo çështje do të bëhej pazar", është shprehur Salihu.

**"Epoka e re":** *Profesor, pas krejt këtyre zhvillimeve sa i përket hetimit të listave të veteranëve si dhe publikimit të listës së veteranëve të 'rrejshëm', si e shihni zgjidhjen e kësaj çështje problematike?*

**Salihu:** Identifikimi i veteranëve të jashtëligjshëm është fitore e drejtësisë dhe funksionalizimit të shtetit ligjor. Kjo është në dobi të qytetarëve të Kosovës dhe në funksion të sundimit të ligjit. Me çështjen e veteranëve është bërë një keqpërdorim masiv i cili është mundësuar prej disa politikanëve për arsye të ndryshme. Më vjen keq që veteranëve të vërtetë, sidomos atyre që kanë dhënë jetën për këtë Kosovë, u kanë qitur një hije të keqe. Çështja e veteranëve urgjentisht duhet të zgjidhet sipas procedurës ligjore. Me vjen mirë që një numër i konsiderueshëm i veteranëve, në krye me kryetarin e OVL UÇK-së, janë vënë në funksion të sundimit të ligjit.

**"Epoka e re":** *Ka kapacitete drejtësia jonë dhe mund ta çojë përpara këtë proces, pavarësisht prej ndikimeve politike dhe kundërshtimit nga veteranët?*

**Salihu:** Ish-prokurori Elez Blakaj ka bërë një punë të madhe dhe të mirë. Ai ka përfunduar hetimin dhe ka dorëzuar aktakuzën aty ku është dashur. Por për ta komprometuar punën e tij në atë listë i kanë futur rreth dy mijë veteranë të ligjshëm. Këtë e ka thënë edhe vetë ish-prokurori Blakaj, i cili ka bërë me dije se këta persona nuk kanë qenë pjesë e akuzës së dorëzuar në gjykatë. Prandaj, kjo është bërë qëllimisht për ta komprometuar punën që është bërë në bazë të ligjit.

**"Epoka e re":** *Ngritja e aktakuzës është kundërshtuar*

# mijë persona



*nga politika dhe shoqatat e luftës, madje këtë javë pati edhe një protestë të veteranëve të cilët kërkuan që aktakuza të hedhet poshtë. Mund të presim ndriçim të plotë të këtij rasti?*
**Salihu:** Ky proces patjetër duhet të ndriçohet deri në fund, përndryshe do të jetë shumë keq. Duhet të gjendet një solucion i cili vërtet do ta vë drejtësinë në vend. 20 mijë keqpërdorues që janë evidentuar nuk mund të nxirren para gjykatës. Kjo është e pamundur teorikisht dhe praktikisht, mirëpo Komisioni Qendror dhe komandantët që kanë nënshkruar të dhënat e pavërteta duhet të nxirren para drejtësisë.

**"Epoka e re":** *Cili është solucioni më i mirë, sipas mendimit tuaj?*
**Salihu:** Solucioni më i mirë do të ishte ndalja e pensioneve. Nëse jo 100 për qind, 98 për qind e atyre që janë në evidencë janë veteranë të jashtëligjshëm apo, siç po i quajnë, veteranë të 'rrejshëm'. Pensionet duhet të ndalen, kurse ata kryesorët duhet të nxirren para gjykatës. Veteranëve të 'rrejshëm' si masë e përkohshme duhet t'u ndalet pensioni. Nëse konstatohet se ata vërtet kanë marrë kundërligjshëm, duhet të detyrohen t'i kthejnë ato mjete. Përndryshe, 20 mijë persona nuk mund të nxirren para gjykatës, mirëpo duhet të nxirren personat kryesorë që i kanë kontribuar kësaj.

**"Epoka e re":** *Si duket, për shkak të numrit të madh, çështja është shpërndarë në gjykata themelore në krejt Kosovën. Ka qenë veprim i duhur?*
**Salihu:** Nuk e di nëse është bërë një gjë e tillë, mirëpo me këtë çështje duhet të merret qendra. As teorikisht e as praktikisht nuk mund të nxirren para gjykatës 20 mijë persona. Nëse duan të kryejnë punë, kjo duhet bërë në qendër, pra në një vend. Nëse ndahet në shtatë gjykata themelore në nivel Kosove, kjo çështje do të bëhej pazar.

**"Epoka e re":** *A është dashur të publikohen të dhënat personale të këtyre personave që pretendohet se jashtëligjshëm gëzojnë statusin e veteranit?*
**Salihu:** Sa unë di, prokurori i lëndës nuk i ka publikuar, por i ka dërguar në gjykatë. Ata që i kanë publikuar në mënyrë të kundërligjshme listat me të dhëna personale duhet të përgjigjen për shkelje të ligjit.

**"Epoka e re":** *Si duhet të veprojë drejtësia në mënyrë që të dihet e vërteta shpejt dhe ky proces të mos zvarritet?*
**Salihu:** Procedura penale duhet të zhvillohet ndaj personave përgjegjës. Fajtorë kryesorë janë komisioni dhe komandantët në terren, sepse po të procedohet ndaj këtyre 20 mijë personave, Kosova duhet të merret edhe pesë vjet me ta. Nuk është praktike dhe nuk është e mundur të bëhet një gjë e tillë. Prandaj, në këto raste duhet të veprohet në interes të përgjithshëm. Nëse duan që ky problem të mos zgjidhet kurrë dhe askush të mos japë përgjegjësi, atëherë le të fillojë procedura ndaj këtyre 20 mijë personave. Nëse shkohet në këtë drejtim do të ketë shmangie nga drejtësia. Shteti duhet të veprojë me pragmatizëm, por duke mos e shkelur ligjin. Kurse nëse duan që të vihet drejtësia në vend, atëherë duhet të ndiqet procedura ndaj personave përgjegjës dhe në këtë mënyrë procesi mund të përfundojë brenda gjashtë muajve, më së largu një vit.

# 77.6 për qind e qytetarëve kundër idesë së shkëmbimit të territorit me Serbinë

**Jeta Krasniqi nga KDI-ja, gjatë prezantimit të të dhënave, ka bërë me dije se pyetjet e këtij sondazhi lidhen me zhvillimet e fundit rreth procesit të dialogut Kosovë - Serbi, rreth rolit të presidentit dhe opozitës, rreth opsionit të shkëmbimit të kufijve në mes palëve si pjesë të një marrëveshjeje eventuale dhe veprimeve të tyre dhe alternativës më të pranueshme të qytetarëve në mes një asociacioni të komunave me shumicë serbe me kompetenca ekzekutive dhe ndryshimit të kufijve të Kosovës.**

**Prishtinë, 28 shtator** - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të premten konferencë për media, në të cilën janë paraqitur rezultatet e sondazhit të shtatë të opinionin publik lidhur me procesin e dialogut Kosovë - Serbi.
Periudha e anketimit ka qenë nga 5 deri më 13 shtator.
Jeta Krasniqi nga KDI-ja, gjatë prezantimit të të dhënave, ka bërë me dije se pyetjet e këtij sondazhi lidhen me zhvillimet e fundit rreth procesit të dialogut Kosovë - Serbi, rreth rolit të presidentit dhe opozitës, rreth opsionit të shkëmbimit të kufijve në mes palëve si pjesë të një marrëveshjeje eventuale dhe veprimeve të tyre dhe alternativës më të pranueshme të qytetarëve në mes një asociacioni të komunave me shumicë serbe me kompetenca ekzekutive dhe ndryshimit të kufijve të Kosovës.
Krasniqi ka treguar se qytetarët janë pyetur se sa janë të kënaqur me qëndrimin që presidenti Hashim Thaçi po i jep procesit të dialogut Kosovë - Serbi. Ajo ka theksuar se janë 75.1 për qind e qytetarëve të cilët janë shprehur të pakënaqur me kahun që presidenti Thaçi po i jep dialogut Kosovë - Serbi, kurse vetëm 20 për qind e tyre janë shprehur të kënaqur me këtë proces.
Kurse sa i përket qëndrimit të qytetarëve nëse do ta pranonin shkëmbimin e territorit në mes të Kosovës dhe Serbisë si pjesë të një marrëveshjeje potenciale, një përqindje mjaftë e lartë prej 77.6 përqindësh të respodentëve kanë thënë se e kundërshtojnë këtë ide.
Shikuar sipas përkatësisë etnike, 80.3 për qind e respondentëve nga komuniteti shqiptar, 38.4 për qind e respondentëve nga komuniteti serb si dhe 62 për qind e respondentëve nga komunitetet e tjera janë shprehur se nuk do ta pranonin shkëmbimin e territorit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si pjesë të marrëveshjejes eventuale në mes të palëve. "Duke konsideruar opsionet e diskutuara aktualisht si alternativa të mundshme për një marrëveshje eventuale në mes palëve, në pyetjen se cilën nga dy alternativat e mundshme qytetarët do të pranonin, përkatësisht ndryshim të kufijve të Kosovës apo asociacion të komunave me shumicë serbe me kompetencë ekzekutive, shumica dërrmuese e respondentëve, përkatësisht 82.9 për qind, janë shprehur se nuk do të pranonin asnjë alternativë, ndërsa 10.5 për qind e tyre do të preferonin më shumë ndryshim të kufijve sesa asociacion të komunave me shumicë serbe për të cilën 6.6 për qind e qytetarëve kanë shprehur mbështetje", ka thënë Krasniqi. Ajo ka shtuar se vlen të theksohet se alternativa më e preferuar për respondentët e komunitetit serb është Asociacioni i Komunave me Shumicë serbe me 57 për qind, ndërsa për komunitetin shqiptar dhe të tjerët ndryshimi i kufijve si preferencë pas asnjërit opsion. Sa i përket pyetjes se çfarë veprimi qytetar do të ndërmerrnin nëse presidentët Thaçi - Vuçiq arrijnë marrëveshje për shkëmbim të territoreve në mes të Kosovës dhe Serbisë në baza etnike, rezultatet nxjerrin në pah se 51.5 për qind e qytetarëve do të protestonin kundër kësaj marrëveshje. Janë 20 për qind e qytetarëve të cilët janë shprehur se do të kërkonin referendum dhe 9 për qind e tyre do të pajtoheshin me këtë marrëveshje. Krasniqi ka bërë me dije se në pyetjen rreth kënaqëshmërisë së qytetarëve me rolin që partitë opozitare po luajnë në procesin e dialogut Kosovë - Serbi, 65.6 për qind e respondentëve janë shprehur të pakënaqur, kurse vetëm 29 për qind kanë thënë se janë të kënaqur me rolin që partitë opozitare po luajnë në këtë proces.



## Ministri Bytyqi vizitoi Bibliotekën e Kongresit Amerikan

Prishtinë, 28 shtator - Në kuadër të takimeve dhe vizitave në institucione të larta të arsimit dhe shkencës që po i realizon gjatë qëndrimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka vizituar Bibliotekën e Kongresit Amerikan, ku është pritur nga Grant G. Harris, drejtor i Sektorit të Evropës.
Ministri Bytyqi u shoqërua nga Grant në shumë dhoma të kësaj biblioteke që është themeluar në vitin 1801 me synimin për të krijuar një koleksion me libra që mund t'i duheshin Kongresit Amerikan dhe sot ajo është biblioteka më e madhe në botë.
Ministri u njoftua nga Grant për rolin dhe rëndësinë e bibliotekës, për historinë interesante të saj dhe të librave që ekzistojnë në këtë bibliotekë, e cila lidhet shumë edhe me emrin e ish-presidentit të ShBA-së, Tomas Jefferson, koleksioni i të cilit është më i çmuari që ka biblioteka.
Në Bibliotekën e Kongresit në Uashington ruhen disa libra të rrallë për Skënderbeun, dy prej të cilëve janë ekspozuar në Uashington me rastin e 105-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.



# Rritet numri i personave me sëmundje të zemrës

EPOKA E RE Faton DËRMAKU



Prishtinë, 28 shtator - Rastet e sëmundjeve të zemrës po bëhen çdoherë e më shqetësuese edhe në Kosovë, pasi po rritet numri i personave që kërkojnë tretman mjekësor, duke arritur deri në 200 për qind më shumë të rasteve të vendosjes së stendave dhe trajtimeve të tjera. Kështu u tha në konferencën për media me rastin e Ditës Botërore të Zemrës, të organizuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, në bashkëpunim me Klinikën e Kardiologjisë dhe Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë.
Ministri i Shëndetësisë, Ali Berisha, ka thënë se sëmundjet e zemrës mbesin ende vrasësit kryesorë të popullatës sonë. "Angazhimi i gjithanshëm ndërinstitucional në parandalimin, diagnostifikimin dhe shërimin e këtyre sëmundjeve është i domosdoshëm", ka thënë ai.
Drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, Naser Ramadani, ka thënë se kjo ditë po shënohet në të gjitha qendrat rajonale të Kosovës.
Përfaqësuesi i QKUK-së, Tefik Bekteshi, ka thënë se QKUK-ja në këtë vit ka bërë shumë në kualitet të shërbimeve që ofrojnë. "Në Kardiologji kemi 4 468 pranime, duke shtuar edhe 740 pranime në Kardiologji dhe Kardiologji Invazive. Kemi 153 operime në këtë vit. Nëse bëjmë një krahasim të rasteve me vitin e kaluar, kemi pasur 99 operime me zemër të hapur, pra është një ngritje prej 160 përqindësh. Deri në këtë ditë kemi bërë 1 780 koronografi që, krahasuar me vitin e kaluar, kanë qenë 845 koronografi. Janë realizuar 1 010 stentime, domethënë proceduar, gjegjësisht implementuar 1 222 stenda. Në vitin e kaluar kemi pasur 55 procedura. Dmth., ka rritje për 200 për qind", ka thënë Bekteshi.
29 Shtatori është Dita Botërore e Zemrës, e cila në shumë vende të botës shënohet duke mësuar për sëmundjet kardiovaskulare.

# Musliu kërkon që urgjentisht të trajtohet Kompleksi Përkujtimor 'Adem Jashari'

EPOKA E RE A. MAVRAJ

Prishtinë, 28 shtator - Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ganimete Musliu, ka thënë se institucionet shtetërore duhet ta marrin me urgjencë trajtimin e Kompleksit Përkujtimor "Adem Jashari" në Prekaz të Skenderajt. Musliu ka thënë për gazetën "Epoka e re" se për shkak të mosveprimit të institucioneve është duke u rrezikuar të humbet historia e Kosovës dhe e komandantit legjendar, Adem Jashari pasi, sipas saj, kullat e tij janë në prag të shembjes. "Po rrezikojmë ta humbin historinë e Kosovës pasi ato kulla janë në prag të shembjes dhe duhet të bëhet konservimi i tyre. I keni parë erërat e forta që ishin në Prishtinë dhe po të ndodhnin edhe dy, atëherë rrezikohet të shemben ato kulla. Ne mund ta bëjmë renovimin e tyre, sepse asnjëherë s'është qysh ishin. Prandaj, duhet të jemi më vigjilentë në këtë drejtim dhe të gjithë deputetët e Kuvendit, pa marrë parasysh nga cila parti janë, duhet të votojnë që të ndahet buxhet për këtë", ka thënë Musliu.
Musliu, e cila është anëtare e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, ka thënë se edhe në mandatin e kaluar ka kërkuar të futet në projeksion buxhetor trajtimi i Kompleksit Përkujtimor "Adem Jashari". E pyetur nëse kanë ndonjë pilot-projekt se sa duhet buxhet për këtë kompleks, Musliu është përgjigjur: "Jo! Ne deputetët nuk kemi ndonjë shifër. Këtë mund



ta dijë drejtori i Komplekseve Përkujtimore, prandaj dhe kam propozuar që ai të vijë në komision dhe të na informojë më gjerësisht", është shprehur deputetja Musliu.

## Një muaj paraburgim për deputetin Shkumbin Demaliaj

Prishtinë, 28 shtator - Gjykata Themelore në Prishtinë e ka miratuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për caktimin e masës së paraburgimit për një muaj për deputetin e Kuvendit të Kosovës, Shkumbin Demaliaj.
Masa e paraburgimit do të jetë në fuqi deri më 27 tetor të këtij viti.
Demaliaj, deputet nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, dyshohet për veprën penale: kanosje ndaj ish-prokurorit Elez Blakaj, i cili ka hetuar më parë çështjen e listës së veteranëve të luftës. Pala thuhet se ka të drejtë ankese kundër këtij vendimi në Gjykatën e Apelit të Kosovës.
Policia e Kosovës, me vendim të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, e ka ndaluar deputetin Demaliaj të enjten dhe e ka dërguar në mbajtje për 48 orë.



# Implementimi i strategjive mbi ndryshimet klimatike, sfidë për Kosovën

Përfaqësues nga institucionet vendore dhe të organizatave të shoqërisë civile kanë vlerësuar se opinioni në Kosovë duhet të informohet mbi rëndësinë e marrjes së masave adekuate për trajtim efikas të ndryshimeve klimatike



EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Balkan Green Foundation (BGF), në kuadër të Konsorciumit Kosovar të Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID), përgjatë "Javës së diplomacisë klimatike 2018" organizuan tryezën me temën "A është Kosova e gatshme për t'i trajtuar ndryshimet klimatike?" Në fjalimin hyrës, drejtori ekzekutiv i Balkan Green Foundation, Visar Azemi, ka pohuar se çështja e ndryshimeve klimatike është një realitet që po e përcjellë Kosovën përditë e më shumë. Sipas tij, Kosova, edhe pse vend i vogël, ka potencial dhe obligim ta shkurtojë dukshëm lirimin e gazrave serrë dhe të jetë shembull në rajon për adoptim të teknologjisë së re për prodhimin dhe konsumimin e energjisë së pastër.
Tryeza u nda në dy panele diskutuese, ku paneli i parë ka diskutuar mbi koherencën legjislative dhe zbrazëtirat në zbatim drejt implementimit të planeve strategjike mbi ndryshimet klimatike.
Ivana Mijatoviq Cernos nga DG Klima, Komisioni Evropian, u shpreh se Kosova edhe pse nuk është nënshkruese e Marrëveshjes së Parisit, duhet të përkushtohet për uljen e emetimeve, caktimin e politika të reja mbi ndryshimet klimatike dhe për ngritjen e kapaciteteve teknike, duke hapur rrugë për zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor në vend.
Nga Ministria e Integrimit Evropian, Ilir Muçaj, ka theksuar se sfida kryesore e Kosovës është pamundësia e të qenit pjesë e mekanizmave ndërkombëtare, mirëpo ndryshimet klimatike janë të përfshira në programet e hartuara në Qeveri, duke qenë se Kosova ka obligime t'i adaptojë politikat shtetërore në hap me trendët dhe direktivat e vendosura nga Bashkimi Evropian.
Rinora Gojani nga BGF/KOSID ka deklaruar se Kosova ka rrugë të gjatë sa i përket integrimit në Bashkimin Evropian, duke qenë se ka vonesa të dukshme për zbatimin e rregulloreve që BE i harton. Më tutje, Gojani ka thënë se presion duhet bërë për shtyrjen e implementimit të strategjive për ngrohjen globale, duke bërë forcimin e veprimeve të nevojshme shtetërore për ndryshimet klimatike.
Ndërsa Avni Sfishta nga GIZ ka theksuar se në emër të Qeverisë gjermane, GIZ është duke e përkrahur Kosovën në fushën e efiçiencës së energjisë. Ai ka thënë se efiçenca e energjisë dhe burimet e rinovueshme, përveç efekteve pozitive, krijojnë treg të punës dhe kontribuojnë për uljen ndikimeve si rrjedhojë e ndryshimeve klimatike.
Paneli i dytë diskutues pati temë sfidat kryesore dhe veprimet e nevojshme për zbutjen e ndryshimeve klimatike në Kosovë, duke diskutuar mbi mundësitë dhe pengesat kyçe për ta parandaluar degradimin e mëtejshëm të mjedisit.
Avdulla Alija nga Universiteti i Prishtinës ka pohuar se sfidë e vazhdueshme për ta shtjelluar temën e ndryshimeve klimatike është mungesa e hulumtimeve shkencore, shifrave dhe fakteve mbi temën në fjalë në Kosovë. Sipas tij, duhet punuar shumë jo vetëm për adaptimin e strategjive, por edhe për hulumtimin dhe studimin e efekteve të tyre në mjedis dhe shoqëri.
Ndërkaq Chad Briggs nga RIT Kosova ka theksuar se duhet pasur parasysh mungesën e të dhënave mbi gjendjen aktuale të mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, gjë që e vështirëson procesin e hartimit të politikave të duhura energjetike dhe mjedisore në mënyrë të strukturuar dhe të vazhdueshme.
Pjesë e panelit ishte edhe Trim Ilazi nga OJQ "PEN", cili tha se ndotja e ajrit, sidomos në sezonin vjeshtë/dimër, është në nivele alarmante në çdo pjesë. Ilazi u shpreh se është e domosdoshme rritja e vetëdijesimit dhe kulturës shoqërore ndaj ndotjes së ajrit dhe mjedisit dhe se duhet ngritur përpjekjet për t'i ndikuar institucionet përgjegjëse për marrjen e veprimeve adekuate për minimizimin e ndryshimeve klimatike në vend.
Në diskutimin e hapur, përfaqësues nga institucionet vendore dhe organizatave të shoqërisë civile u pajtuan se është e rëndësishme që publiku i gjerë të informohet mbi rëndësinë e marrjes së masave adekuate për trajtim efikas të ndryshimeve klimatike, e cila po krijon sfida kritike sociale dhe natyrore në të gjithë globin. "Java e diplomacisë klimatike 2018" është një iniciativë e organizuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, tashmë për të dytën herë, dhe ka për qëllim ngritjen e vetëdijes për ndryshimet klimatike dhe zbutjen e trendëve negativë të ndryshimeve klimatike në Kosovë.

# Sot mbahet protesta e Vetëvendosjes, policia ndërmerr masat për ta mbikëqyrur



PRISHTINË, 28 SHTATOR (ER) - Sot (e shtunë), në orën 14:00, në Prishtinë, do të mbahet protesta e organizuar nga Lëvizja Vetëvendosje, me thirrjen "Një popull s'i nënshtrohet një njeriu". Sipas përfaqësuesve të Lëvizjes Vetëvendosje, presidenti Hashim Thaçi, pa autorizim, pa legjitimitet e kokë në vete, po zhvillon negociata me Vuçiqin për territorin e sovranitetin e vendit.
Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë me dije se protesta e cila do të nisë te Biblioteka Kombëtare do të jetë paqësore. "Vendin e grumbullimit e kemi te Biblioteka Kombëtare në orën 14:00. Kjo protestë nga fillimi deri në mbarim është paqësore. Mos u besoni atyre që parashikojnë për dhunë, sepse ata dëshirojnë dhunë, sepse ata tashmë janë më të dhunshmit të cilët ne nuk i pranojmë e do t'i kundërshtojmë me protestën tonë. Protesta do të jetë paqësore dhe vetëm paqësore. Protesta e 29 shtatorit, në kushtet e shpërfilljes së popullit dhe e deligjitimitet të presidentit, nuk është veçse një e drejtë qytetare e jona, por edhe detyrë demokratike për secilin prej nesh", ka thënë Kurti.
Policia e Kosovës ka bërë me dije se ka marrë të gjitha masat për protestën e nesërme të organizuar nga Lëvizja Vetëvendosje.
Policia ka njoftuar se zyrtarë të Policisë së Kosovës kanë realizuar një takim me organizatorët e kësaj proteste, për të diskutuar rreth mbarëvajtjes së qetë të kësaj proteste. "Policia e Kosovës si institucion i zbatimit të ligjit do të ndërmarrë të gjitha veprimet në përputhje të Kushtetutës së Kosovës, ligjeve në fuqi dhe planit të hartuar, për ta garantuar rendin dhe qetësinë publike, për mbarëvajtjen e protestës si dhe për krijimin e mundësisë së lëvizjes së lirë të të gjithë qytetarëve, duke përfshirë masat në riorientim të trafikut rrugor", është theksuar në njoftimin e Policisë së Kosovës.
Në këtë njoftim është thënë, ndër të tjera, se Policia e Kosovës do të jetë profesionale, do të respektojë zbatimin e ligjit, çdoherë duke respektuar të drejtat e qytetarëve si dhe duke treguar sjellje profesionale gjatë realizimit të detyrave policore.

# MPMPS-ja kërkon nga punëdhënësit t'i rrisin masat e sigurisë në punë

FERIZAJ, 28 SHTATOR (ER) - Zëvendësministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMPS) ka vizituar të premten disa kompani të sektorit privat në Ferizaj. Në cilësinë e kryesuesit të Këshillit Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë u njoh afër me sigurinë dhe kushtet e punës që këto kompani ofrojnë për punëtorët.
Dukolli, i shoqëruar nga anëtarët e Këshillit, ka vizituar kompaninë ndërtimore 'Vahidi', e cila ka të punësuar 17 punëtorë, si dhe Fabrikën e Prodhimeve të Drurit 'Kosova Model', të pronarit Milaim Sopaj, e cila ka rreth 37 punëtorë.
Gjatë vizitës në punishtet e këtyre kompanive, KNSShP u interesua për kushtet e sigurisë, për pajisjet e punës dhe për zbatimin e masave parandaluese për t'i evituar lëndimet në punë. Me këtë rast zëvendësministri Dukolli ka apeluar tek punëdhënësit që t'i rrisin masat e sigurisë jo vetëm për hir të ligjeve dhe rregulloreve, por më shumë për faktin se jetët e njerëzve janë më të shtrenjta dhe më të çmueshme se çdo përfitim tjetër material.
Po ashtu, ai mori premtime nga pronarët e kompanive se do t'i zbatojnë me përpikëri ligjet, këshillat dhe udhëzimet që shkojnë në dobi të mbrojtjes së shëndetit dhe jetëve të punëtorëve.
Këshilli Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë do të vazhdojë edhe më tutje të vizitojë dhe monitorojë kompani dhe industri të tjera për ta parë nga afër zbatimin e legjislacionit për siguri dhe shëndet në punë jo vetëm për ta afirmuar domosdoshmërinë e mbrojtjes së shëndetit të punëtorëve, por edhe për të shkëmbyer ide dhe përvoja me kompani të ndryshme në funksion të sigurisë në punë.



# Kompanitë turke të interesuara të investojnë në Kosovë



PRISHTINË, 28 SHTATOR (ER) - Zëvendëskryeministri dhe ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka pritur një delegacion turk të kompanisë konsulente për investime "GD" në Turqi, e udhëhequr nga Gozde Gunugur. Në këtë takim, përveç punës së Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, u bisedua edhe për investimet strategjike që mund të bëhen në Kosovë.
Gashi u shpreh i gatshëm t'u ofrojë ndihmë kompanive serioze turke sa iu përket informacioneve dhe mundësive që ka Kosova në sektorët strategjikë. Ndërkaq zyrtarët e kompanisë "GD" kanë shprehur interesimin e kompanive turke për të investuar në Kosovë, sidomos në miniera, energji të ripërtërishme dhe turizëm. Meqë procesi i investimeve strategjike është atraktiv dhe lehtëson procedurat, u kërkua të organizohet një takim me partnerët investues të kompanisë konsulente "GD", për t'i prezantuar mundësitë që ka Kosova në miniera dhe energji.

# 'Limak'-u fillon investimet në Shkup

**Kompania "Limak", ka filluar zyrtarisht realizimin e projektit që parasheh ndërtimin e një kompleksi biznesor banimi dhe rruge nëntokësore në Shkup**

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Kompania "Limak", e cila menaxhon Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", ka filluar zyrtarisht realizimin e projektit që parasheh ndërtimin e një kompleksi biznesor banimi dhe rruge nëntokësore në Shkup. Projekti, i cili kap shifrën prej 250 milionë dollarësh, parashihet të realizohet brenda 40 muajve të ardhshëm dhe përfshin një kompleks biznesor, qendër tregtare, hotel dhe hapësira parkingu. "Ky është projekti ynë i parë në Maqedoni, një vend në të cilin ndihemi si në shtëpi. Jemi gjithmonë në kërkim të mundësive për të investuar këtu, sepse ne besojmë në fuqinë punëtore të kualifikuar dhe trendët ekonomikë", ka thënë Serdar Bacaksiz, anëtar bordi i kompanisë "Limak".
"Limak" planifikon ndërtimin e rrugës nëntokësore për 22 muaj, ndërkaq i gjithë kompleksi do të ndërtohet për 40 muaj. Projekti do të ndërtohet me standarde të larta dhe do t'i përshtatet Muzeut të Qytetit në Shkup.



# Bizneset italiane, rumune dhe bullgare kërkojnë treg në Kosovë



Një delegacion i bizneseve italiane, rumune dhe bullgare, i kryesuar nga Veseli Koshev, kryetar i Auro-Asian Association for Business, Culture and Friendship, kanë vizituar të premten Aleancën Kosovare të Bizneseve (AKB), ku janë pritur nga kryetari i saj, Agim Shahini, me të cilin kanë diskutuar për mundësitë e reja për bashkëpunim

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, i ka njoftuar delegacionet e bizneseve italiane, rumune dhe bullgare, lidhur me ambientin afarist dhe të bërit biznes në Kosovë, si dhe për sistemin fiskal dhe investiv, i aplikuar në Kosovë, si më i favorshmi në Ballkanin Perëndimor. "Ekonomia e Kosovës ka kaluar tranzicionin me sukses nga ai emergjent tani në zhvillim, ku përmes procesit të privatizimit kanë aderuar në Kosovë shumë korporata të fuqishme për të investuar, ku Italia është një nga vendet që ka dhënë kontribut të madh për zhvillimin e ekonomisë, pa harruar edhe bizneset nga Bullgaria dhe rumune që janë në Kosovë në sektorë të ndryshëm. Kosova është lidere në Ballkan për përparësitë që ua ofron kompanive të vendeve të Bashkimit Evropian. Këtë të mirë po e shfrytëzojnë investitorët që vijnë nga vendet e juaja", është shprehur Shahini.

Ndërkaq Veseli Koshev, kryetar i Auro-Asian Association for Business, Culture and Friendship, ka thënë se ndihet i inkurajuar me ofertat e Kosovës për investime për të promovuar edhe në vendet e Azisë dhe të Evropës. "Bizneset po kërkojnë atje ku ka taksa më pak e fitim më shumë. Për këtë dua t'ju themi se ne jemi partnerë për ta promovuar Kosovën kudo që ne punojmë dhe veprojmë", ka deklaruar ai.

Ndërsa Pasquale Lacasella i konsorciumit "Net Solution" nga Italia ka thënë se është hera e parë që është në Kosovë. Ai ka thënë se pas prezantimit që bëri kryetari i AKB-së për mundësinë e investimeve këtu, ka treguar se do të thërrasë biznese nga Italia të bashkinvestojnë në Kosovë.

# Bruto Produkti Vendor shënoi rritje për 4.7 për qind

PRISHTINË, 28 SHTATOR (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të enjten raportin për Bruto Produktin Vendor (BPV) për tremujorin e dytë (TM2) 2018, sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve me çmime aktuale dhe konstante. BPV-ja në TM2 të vitit 2018 ka shënuar rritje reale për 4.7 për qind në krahasim me TM2 të vitit 2017.

Rritja reale e BPV-së sipas aktiviteteve ekonomike është si vijon: aktivitetet financiare dhe të sigurimit (33.1 për qind); industria nxjerrëse (6.5 për qind); tregtia me shumicë dhe pakicë (5.6 për qind); ndërtimtaria (5.2 për qind); transporti dhe magazinimi (5.1 për qind); administrimi publik (5 për qind); hotelet dhe restorantet (3.5 për qind); afarizmi me pasuri të patundshme (2 për qind); bujqësia, gjuetia, pylltaria (0.9 për qind); industria përpunuese (0.2 për qind).

Ndërsa rënie reale kishte në të dhënat e furnizimit me energji elektrike, ujë dhe trajtim të mbeturinave (4.2 për qind). Sipas ASK-së, BPV-ja, sipas qasjes së shpenzimeve, ka pasur rritje në: formimin e brutokapitalit (12.2 për qind); eksportin e mallrave dhe shërbimeve (12 për qind); importin e mallrave dhe shërbimeve (11.7 për qind); shpenzimet e konsumit final të Qeverisë (4.7 për qind); shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe institucionet jopërfituese në shërbim të ekonomive shtëpiake (IJPShESh) (4.4 për qind), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.



# Nis asfaltimi i segmentit të rrugës Marinë - Tërstenik

DRENAS, 28 SHTATOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, bashkë me kryetarin e Drenasit, Ramiz Lladrovci, kanë vizituar të premten vendin në të cilin kanë nisur punimet për asfaltimin e rrugës Rajonale R129, segmenti Marinë - Tërstenik, në gjatësi prej tri kilometrash.
Ministri Lekaj ka kërkuar nga operatori ekonomik që ta respektojë dinamikën e paraparë të punës dhe implementimin e hollësishëm të projektit në mënyrë që kjo rrugë të përfundojë me kohë dhe me tërë infrastrukturën përcjellëse.
Bëhet me dije se ky projekt po zhvillohet sipas dinamikës së paraparë dhe bën pjesë në investimet e Ministrisë së Infrastrukturës për modernizimin e rrugëve anembanë Kosovës.





# Ferizaj shënoi Ditën e Dëshmorëve dhe 20-vjetorin e Epopesë së Jezercit

FERIZAJ, 28 SHTATOR (ER) - Komuna e Ferizajt ka shënuar 20-vjetorin e Epopesë së Jezercit dhe Ditës së Dëshmorëve të kombit. Në kuadër të kësaj ngjarje, ferizajasit kanë marshuar të premten drejt Varrezave të Dëshmorëve, aty ku prehen eshtrat e dëshmorëve nga kjo anë, për të nderuar gjakun e tyre të derdhur për liri.
Po në nderim të dëshmorëve, kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, deputetët e Kuvendit të Kosovës, Elmi Reçica dhe Mexhide Mjaku Topalli, kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Gafurr Bytyçi, drejtorë komunalë dhe anëtarë të kabinetit qeveritar, veteranë, invalidë të luftës e familjarë të dëshmorëve, janë përkulur para shtatoreve të komandantëve të shquar, Rexhep Bislimi, për të vazhduar tutje tek shtatorja e heroinës Hyrë Emini. Gjithashtu, janë bërë homazhe edhe te shtatorja e dëshmorit të kombit, Naim Beka e Afrim Kalanica, për të vazhduar tutje te shtatorja e dëshmorëve, Driton Islami-Toni, Sadik Bega-Mortaja, Brahim Ademi-TT-ja, Kemajl Hetemi si dhe tek shtatorja e dëshmorit Agim Matoshi.
Dita e Dëshmorëve ndërlidhet me betejën e njohur si Epopeja e Jezercit, e cila është zhvilluar në fund të shtatorit të vitit 1998, me ç'rast në këtë vend kanë rënë me armë në dorë luftëtarët e UÇK-së, Gursel e Bajram Sylejmani, Kemajl Hetemi, Sejdi Sejdiu, Sali Baliu, Lulzim Guta, Arsim Zeqiri, Bashkim Vishi dhe Nazim Terziu.



# GAP-i: Gjilani është shembull i bashkëpunimit me shoqërinë civile

GJILAN, 28 SHTATOR (ER) - Nën organizimin e Institutit GAP në Gjilan është mbajtur të premten konferenca me temë "Zbatimi i MSA-së në nivel komunal", në të cilën ka marrë pjesë edhe kryetari i kësaj komune, Lutfi Haziri. Në hapje të kësaj konference, përfaqësuesi i GAP-it, Bekim Salihu, ka thënë se Gjilani është shembull i bashkëpunimit me shoqërinë civile. "Po e them që në hapje të takimit se Gjilani është shembull në nivel të Kosovës sa i përket bashkëpunimit me shoqërinë civile. Edhe kur jemi pajtuar, edhe kur nuk jemi pajtuar në pika të ndryshme, kryetari i komunës gjithmonë ka qenë i gatshëm për bashkëpunim", ka thënë Salihu.
Të arriturat më të mëdha të kësaj komune, sipas Salihut, për përmbushjen e obligimeve që dalin nga MSA-ja, llogariten të jenë hartimi i buxhetit me pjesëmarrje të qytetarëve, ngritja e kapaciteteve të "One stop shop", hapja e zyrës së Avokatit të Popullit, buxhetimi gjinor, zbatimi i të drejtave pronësore, zbatimi i ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare etj., ndërkaq si sfidë janë potencuar mungesa e legjislacionit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, reforma e administratës publike, trajnimi i stafit përkatës për zbatimin e planit komunal për efiçiencë të energjisë elektrike. Ndërsa kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka falënderuar Institutin GAP për monitorimin, bashkëpunimin profesional dhe rekomandimet, duke shtuar se të gjitha sugjerimet dhe gjetjet e tyre të trajtohen me seriozitetin më të madh sa i përket MSA-së.

# Miratohet buxheti i Komunës së Prishtinës për vitin 2019

PRISHTINË, 28 SHTATOR (ER) - Kuvendi Komunal i Prishtinës ka miratuar të premten buxhetin për vitin 2019, i cili kap vlerën prej 87 milionë eurosh. Në favor të këtij buxheti kanë votuar 26 asamblistë, 16 ishin kundër dhe një ka abstenuar. Kryetari i kësaj komune, Shpend Ahmeti, ka thënë se ky buxhet do të fokusohet në infrastrukturë dhe investime në çdo lagje të kryeqytetit. "Sot në Kuvendin Komunal të Prishtinës kaloi propozim-buxheti për vitin 2019, që është buxheti më i lartë ndonjëherë në vlerën prej 87 milionë eurosh. Fokusi më i madh i buxhetit është në infrastrukturë me investime në çdo lagje. Në ditët dhe javët në vijim do të prezantojmë pjesë nga buxheti që qytetarët të jenë të informuar. Urime të gjithëve!", ka thënë Ahmeti.



Në 50-vjetorin e demonstratave të 1968-s

# NGA DEMONSTRATAT E 1968-s E DERI TEK UÇK-ja

**Më 27 nëntor 1968 studentët shqiptarë në Prishtinë, Ferizaj dhe Gjilan thyen tabunë e të demonstruarit në shtetin komunist jugosllav. Më 11 mars 1981 në Prishtinë u "përmbysën pjatat" dhe filloi përmbysja e sistemit komunist në ish-Jugosllavi. Ndërsa studentët shqiptarë më 1 tetor 1997 protestuan paqësisht në Prishtinë kundër dhunës serbe dhe thyen rehatinë e "politikës paqësore". Më 28 nëntor 1997 paraqitja dhe veprimi ushtarak i UÇK-së prishi shëmtinë e përçarjes dhe qetësinë e nënshtrimit të heshtur, e cila shkonte kah nënshtrimi dhe pajtueshmëria me robërinë e dhunës okupuese serbe**

Shkruan: Ismail GASHI-SLLOVIA

Ngjarjet e 1968-s ishin shpërthimi i parë i demonstrimit të hapur për kërkesat tona të natyrshme politike e kombëtare. Praktikisht këto ishin demonstratat e para në shtetet e lindjes me sistem komunist. Në Nëntorin e madh u dëshmua se: Te shqiptarët në Kosovë dhe treva të tjera etnike shqiptare në ish-Jugosllavi nuk është fshirë e as plotësuar aspirata e ndjenjës kombëtare për liri dhe pavarësi. Aspiratë, kujtesë pozitive historike e përcaktuar, që nga Lidhja Shqiptare të Prizrenit (1878), dhe e përsëritur në Mbledhjen e Bujanit, ditën e fundit të 1943-s dhe dy ditët e para të 1944-s, e thënë me këmbëngulësi e trimëri, nga komunistët shqiptarë, ku ishin të pranishëm edhe përfaqësues serbë, por edhe të huaj, e ripërsëritur edhe me grykën e pushkës e trimëri kundërshtuese politike e kombëtare nga Shaban Polluzha. Pas luftës e shprehur edhe politikisht dhe kombëtarisht në "Procesin e Prizrenit", e shtypur nga komunistët sllavë me kodet komuniste, me dënime drakonike deri në pushkatime, me qëllim që, t'u tregohet trishtueshëm shqiptarëve se kanë trokitur në dyer të "gabuara", ndëshkimet komuniste-sllave do t'ju fusin frikë e tmerr. Të njohura e të përjetuara ishin grupe të shumta veprimtarësh të çështjes kombëtare dhe individë shqiptarë që përjetonin tmerre në trajtimet policore serbe dhe dënimet të rënda burgu për "veprimtari armiqësore" të individëve e grupeve të shumta shqiptare. Në dimrin e 1955/56 UDB-a serbe organizoi "Aksionin e Armëve" për rrahjen, frikësimin e ndjekjen masive të shqiptarëve kur, gjoja, në kërkim të armëve, trajtoi, rrahu, gjymtoi me qindra e mija shqiptarë dhe vrau tre nga ata. Shpërngulja e disa qindra mija shqiptarëve në Turqi dëmtoi më shumë se kurrë më parë substancën kombëtare shqiptare. Pastaj, në vazhdimësi UDB-a u bë hije përcjellëse e ndjekjes së shqiptarëve, duke i arrestuar e trajtuar me dhunë fizike e psikike, duke i kërcënuar, për punën, bisedat, shpeshherë edhe të zgjeruara, deri në shpifje e sajime për mendimin përcaktues kombëtar. Janë të njohura burgosjet e veprimtarëve të dalluar të çështjes kombëtare, Kadri Halimi, Metush Krasniqi, Ali Aliu dhe strallit të madh që do të shndërrohet në simbol të rezistencës kombëtare, Bacë Adem Demaçi, më 1958, dhe përsëri me goditje edhe më të rëndë e me masa edhe më të ashpra ndëshkuese më 1964, edhe me më shumë bashkëveprimtarë 1975.

Gjithnjë në ndjekje të shqiptarëve nga sistemi komunist titist, ndër ta edhe të disa shqiptarëve, të cilët me verbëri shërbëtori ishin në shërbim të okupuesit.

Gjithë sistemi komunist jugosllav ishte në vetëbindje për stabilitet politik sepse, sipas tyre, Titoja kishte krijuar një opinion personal, por edhe për shtetin jugosllav dhe politikën ndërkombëtare, se sistemi komunist vetëqeverisës ka një rend komunist të veçantë liberal me të drejta të barabarta për të gjitha nacionalitetet e shumta që jetojnë në këtë shtet të përbashkët. Këtë sistem komunistët sllav praktikisht e kishin improvizuar të tillë, por nga brenda e mbanin nën kërcënim të ligjit e aplikim të diktatit e dhunës.

Këtë dhunë të ngritur në nivel shtetëror do ta "damkosë" e do t'ia prishë namin ndërkombëtar e përbrenda rehatinë, rinia e porsafilluar intelektuale patriotike, studentore shqiptare, e mbështetur dhe e përkrahur nga masat shqiptare, me grupin e studentëve të 6 tetorit 1968 në Prizren, e sinkronizuar vazhdoi, më 8 tetor në Suharekë/Therandë, më 19 tetor në Pejë e më 27 nëntor 1968 në skenën e madhe në Prishtinë, Ferizaj dhe Gjilan. Demonstratat e studentëve kosovarë u shtrinë edhe në hapësira shqiptare jashtë Kosovës. Demonstrata me kërkesa kombëtare kishte edhe në Tetovë më 22 e 23 dhjetor 1968 dhe në Ulqin më 11 qershor 1969. Me demonstrim të hapur, e kërkesa të arsyeshme kombëtare, e vendosmëri të guximshme kundër sistemit antishqiptar komunist jugosllav.

U demonstrua kundër padrejtësisë e shkeljeve që ai sistem bënte ndaj shqiptarëve, padrejtësisht të ndarë nga tërësia shtetërore etnike kombëtare, e të ndaluar prej atdheut, historisë, gjuhës dhe simboleve kombëtare, popullit dhe shtetit të tyre - Shqipërisë. Këto vlime shpërthyese, si vullkani, dolën papritur e paparashikuar nga asnjë nivel e mjedis politik i sistemit vendor komunist sllav.

Këto demonstrata, pavarësisht prej dhunës dhe represionit që kishin aplikuar okupuesit komunistë ndaj shqiptarëve, ishin befasuese dhe shqetësuese për politikën dhe shtetin jugosllav, ishin dëm e dëshpërim për sistemin politik komunist, aq sa ishin kurajuese e dëshmi e zgjimit kombëtar për shqiptarët. Pasi pushtetarët jugosllavë kishin mendje të mbushur, se shqiptarët i kanë shtypur deri në atë nivel, sa ua kanë topitur mendjen për ringritje në kuptimin kombëtar.

Opinioni politik kishte bindje se rehatia material që, as ajo nuk ishte në nivelin e viseve e popujve të tjerë, do t'i mbajë kështu të qetë, pa ndonjë arsye të ndonjë ringjalljeje të ndjenjës kombëtare a fetare, edhe për shumë kohë të ardhme.

Po ashtu, këto demonstrata ishin dëshpërim për sistemin dhe "famën" që kishte Jugosllavia, personalisht Titon, politikën ndërkombëtare jo vetëm në bllokun e tretë të të painkuadruarve, për të cilin Tito e Jugosllavia, bashkë me Nehrun e Indisë e Naserin e Egjiptit, praktikisht ishin personalitete më popullore në politikën ndërkombëtare, (Konferenca e Parë Themeluese u mbajt më 1961 në Beograd), që mendohej të qëndronte dhe t'u kundërvihej dy blloqeve ideologjike të forcave të fuqishme ushtarake, bllokut kapitalist NATO, dhe Paktit Ushtarak Komunist të Varshavës.

Në demonstratat e nëntorit 1968 u bënë këto kërkesa: Që Kosova të ketë Kushtetutë, e jo statut, siç e kishte deri atëherë. Të ketë universitet në vete, jo në kuadër të Beogradit. Që shqiptarët të kenë të drejtën e papengueshme në përdorimin e simboleve kombëtare, flamurit kombëtar shqiptar, për çka deri atëherë ishin ndjekur dhe burgosur shumë atdhetarë, si Bacë Adem Demaçi, e shumë veprimtarë të çështjes kombëtare shqiptare. Ndërsa kërkesë kryesore - boshti, ishte Kosova Republikë, e cila shqetësoi shumë themelet e sistemit dhe strukturat politike, antishqiptarit Tito dhe atyre që ishin rreth tij, madje shqetësim shprehën edhe kuadrot komuniste shqiptare, të cilat ishin në shërbim komunist sllave. Ky "tërmet" shkundulloi rehatinë e improvizuar të sistemit komunist jugosllav. Me këto kërkesa dhe të tjerat, që kërkonin korrigjime në sistemin ekonomik, jehuan thellë në opinionin e brendshëm dhe atë botëror.

Demonstratat e 27 nëntorit 1968 ishin ngjarjet e para qe ia prishën "namin" e imigjit politik dhe shtetëror propagandës sllave të Jugosllavisë vetëqeverisëse të "Vëllazërim-Bashkimit" të kombeve dhe kombësive në Jugosllavi.

Këto ngjarje nuk shpëtuan pa u ndëshkuar nga "buzagazi" me mëzdrak pas shpine Tito, duke i dënuar organizatorët dhe pjesëmarrësit me vite burg të rëndë, dënime e ndjekje të shqiptarëve të cilat, sikur u duken të mangëta, do t'i plotësojë edhe më 1972, në emër të "Letrës së Titos", kur u ndëshkuan me largim nga puna e forma të tjera ndjekjeje e ndëshkimi qindra atdhetarë shqiptarë, të cilët u kishin "shpëtuar" komiteteve dhe niveleve partiake të 1968-s.

Ndëshkimet nuk thyen, as nuk zbehen ashpërsinë e vendosmërisë këmbëngulëse për kërkesat e parashtruar në demonstrata. "Zhdërvjelltësia" e politikës komuniste sllave u tregua hulumtuese në prekjen emocionale të shqiptarëve, për fillim provoi me lejimin e flamurit kombëtar në përdorim zyrtar, më 1969. Më 1970 u detyrua ta lejojë hapjen e Universitetit.

Në vazhdim, në vitin 1971, lëshoi në diskutim publik amendamentet e punëtorëve që u finalizuan me Kushtetutën e Kosovës më 1974. Me përmbushjen e kërkesave të studentëve, kuadrot komuniste shqiptare, të cilat për 20 vjet, nga 1948-1968, nuk kishin hapur asnjëherë gojën në asnjë nivel apo mjedis, as për dhunën shtetërore dënimin e burgosjet e shumta, ndjekjen dhe rrahjen ndaj shqiptarëve, as për dëbimin e tyre në Turqi.

Tash filluan të rrahin gjoks e të krrokatin prapa shpine të padronëve të cilëve verbërisht u shërbenin, se këto ishin merita dhe këta meritorët që nxorën këto të drejta për popullin e tyre shqiptar. Madje, disa nga ta, që janë të gjallë ende sot në Kosovën e pasluftës, po krrokatin për këto plotësime të kërkesave të arsyeshme dhe të drejta kombëtare e njerëzore të shqiptarëve, të drejta që rinia studentore atdhetare shqiptare i nxori me sakrificë dhe vuajtje, me mund, vuajtje e gjak, madje edhe duke shtruar jetën e tyre drejt fitores.

Demonstratat e nëntorit 1968 ishin nisma, ishin stralli që nuk ndali rrugëtimin atdhetar të vazhdimësisë drejt realizimit dhe aspiratës qendrore, ndarjes së Kosovës nga Serbia dhe mëvetësimit të saj shtet i pavarur e neutral.

Gjitha përpjekjet e atdhetarëve shqiptarë kalonin përmes sakrificës dhe rrezikimit nga sistemi administrativ komunist dhe sigurimi i shtetit - UDB-a. Administrata shtetërore ashpërsonte dhunën dhe ndjekjet, kudo që hetonte, përmes langonjve të saj, për qitje kokë, apo zë në drejtim të çështjes shqiptare. Kështu u ndoqën dhe u dënuan ashpër nga 15 deri në 4 vjet burg të rëndë, Grupi i Kamenicës 1975, prej 35 intelektualëve e veprimtarëve të spikatur të cilët kërkuan prishjen e shenjtë të bashkëjetesës.

Po kështu, më 1979, pas vizitës së fundit të Titos në Kosovës, armikut më tinëzar të shqiptarëve, në fillimet e vjeshtës 1979, vizitë të cilën rinia dhe intelektualët shqiptarë e pritën me parulla e shkrim të ndryshme, se nuk je i dëshiruar për hapësirat shqiptare, për çka Tito urdhëroi politikën dhe sigurimin administrativ - UDB-n e shtetit që, të arrestohen ata që hodhën parulla dhe shprehën pakënaqësi për këtë vizitë të tij. Menjëherë, sigurimi filloi arrestin dhe për pak ditë arrestoi e burgosi mbi 400 të rinj e të reja, nxënës, studentë, mësimdhënës dhe intelektualë të niveleve dhe mjediseve të ndryshme të Kosovës. Pas trajtimeve policore dhe torturave fizike e shpirtërore, para "ligjit" dolën dhe u dënuan nga 8 deri në 4 vjet, 8 veprimtarë të çështjes kombëtare. **(Vijon)**



## Gjermanisë i duhen prova për ta shpallur lëvizjen e Gulenit "terroriste"

**BERLIN, 28 SHTATOR** - Kancelarja gjermane, Angela Merkel tha se vendi i saj ka nevojë për më shumë prova për ta shpallur terroriste lëvizjen e klerikut turk, Fetullah Gulen.
Turqia i kërkon Gjermanisë të bëjë një gjë të tillë, duke thënë se lëvizja e Gulenit qëndron prapa përpjekjes për grusht shteti në Turqi, në vitin 2016.
Merkeli i bëri komentet në një konferencë për media në Berlin, së bashku me presidentin turk, Recep Tayyip Erdogan. "Ne i marrim shumë seriozisht provat e Turqisë, por na duhen më shumë materiale për ta klasifikuar këtë lëvizje si terroriste, ashtu siç kemi bërë me grupin Partia e Punëtorëve të Kurdistanit", tha Merkeli.
Erdogani, po ashtu, kërkoi nga Berlini që t'i ekstradojë, siç tha ai, qindra mbështetësit e Gulenit që jetojnë në Gjermani.
Erdogani ndodhet në vizitë në Gjermani, në përpjekje për t'i ulur tensionet midis dy vendeve. Në mars të vitit të kaluar, Erdogani i ka krahasuar zyrtarët gjermanë me nazistët, pasi ata ia kanë anuluar tubimet, që ai ka planifikuar t'i mbajë për diasporën turke në Gjermani, në prag të një referendumi të rëndësishëm për pushtetin e tij.
Berlini po ashtu e ka kritikuar Erdoganin për shtypjen e kundërshtarëve politikë, pas puçit të dështuar në Turqi.


Tobias SCHWARZ (AFP)

# Reagime ndaj fjalimeve të ashpra të presidentit Trump në OKB

**Kina ka mohuar me forcë akuzat e presidentit amerikan Donald Trump, se Pekini po përpiqet të ndërhyjë në zgjedhjet për në Kongres në ShBA që do të mbahen në nëntor**



**UASHINGTON, 28 SHTATOR** - Ndërkohë që udhëheqësit botërorë po analizojnë përplasjet në takimin e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork këtë javë, Kina ka mohuar me forcë akuzat e presidentit amerikan Donald Trump se Pekini po përpiqet të ndërhyjë në zgjedhjet për në Kongres në Shtetet e Bashkuara që do të mbahen në nëntor. Ndërkohë, janë shtuar përplasjet diplomatike në mes të Shteteve të Bashkuara dhe palëve të tjera nënshkruese të marrëveshjes bërthamore të vitit 2015 me Iranin, pasi Shtetet e Bashkuara po përgatitën të vendosin sanksione të reja ndaj Teheranit.
Akuzat e presidentit Donald Trump kundër Kinës në OKB befasuan shumë të pranishëm. Në një konferencë shtypi të mërkurën në mbrëmje, presidenti u pyet se çfarë provash kishte për pretendimet e tij. "Do të dalin. Nuk mund t;ju them tani. Por ka prova, nuk e kam thënë këtë pa arsye", tha ai.
Kina i ka mohuar me forcë akuzat për përpjekje për të ndikuar në politikën amerikane. Disa analistë, si Steve Tsang i Institutit për Kinën, theksojnë se presidenti Trump nuk e përmendi Rusinë. "Duket sikur akuzat që presidenti Donald Trump i bëri ndaj Kinës, kur me qëllim nuk e përmendi Rusinë, ishin një përpjekje për të zhvendosur vëmendjen brenda Shteteve të Bashkuara. Kinezët janë mjaft të zemëruar për këtë. Dhe unë mendoj se Putini në Rusi është mjaft i kënaqur me këtë", tha ai.
Akuzat e presidentit Trump, së bashku me rritjen e tarifave tregtare, shënojnë një përshkallëzim të madh të tensioneve mes Uashingtonit dhe Pekinit. "Çështja kryesore për Kinën është statusi dhe qëndrimi i Presidentit Xi dhe i gjithë partisë komuniste. Presidenti Xi nuk mund ta lejojë dhe nuk do të pranojë që të duket i dobët përpara një sulmi amerikan si ky", mendon Steve Tsang, Instituti për Kinën, Universiteti Soas i Londrës.
Gjatë takimit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të mërkurën, presidenti Trump u përqendrua edhe në pikëpamjet e tij mbi Iranin, duke e akuzuar atë për "përhapje të kaosit, vdekjes dhe shkatërrimit". "Unë mendoj se ai po përpiqet të qetësojë aleatët e tij në rajon, si Këshilli i Bashkëpunimit të vendeve të Gjirit, Arabia Saudite dhe Izraeli. Dhe unë mendoj se kjo është shumë e rëndësishme për të, sepse ai është përpjekur t'i përmirësojë marrëdhëniet e tensionuara, që aleatët kishin me Obamën", shprehet Aziz Alghashian, analist i Lindjes së Mesme, Universiteti i Eseksit.
Pesë vendet e tjera, nënshkruese të marrëveshjes bërthamore të vitit 2015 me Iranin, Britania, Franca, Gjermania, Kina dhe Rusia, duan të krijojnë një sistem alternativ pagesash për të anashkaluar sanksionet amerikane ndaj Teheranit. Sekretari i Shtetit Mike Pompeo të enjten reagoi me zemërim. "Duke mbështetur të ardhurat për regjimin ju po forconi statusin e Iranit si mbështetësi numër një i terrorizmit", tha ai.
Ndërsa presidenti i Iranit, Hassan Rouhani, vlerësoi përpjekjet për të mbajtur gjallë marrëveshjen bërthamore. "Deri sa ne vazhdojmë t'i marrim përfitimet e premtuara në bazë të asaj marrëveshjeje për vendin dhe popullin tonë, ne do të mbetemi pjesë e saj. Nëse situata ndryshon, ne kemi rrugë dhe zgjidhje të tjera", tha ai.
Sanksionet e reja amerikane ndaj Iranit do të hyjnë në fuqi në nëntor, dhe presidenti Trump është zotuar se ato do të jenë më të ashpra se kurrë më parë.

## Kina dhe Rusia, kundër ShBA-së për sanksionet ndaj Koresë

**NJU JORK, 28 SHTATOR** - Shtetet e Bashkuara janë përplasur me Kinën dhe Rusinë në Kombet e Bashkuara rreth thirrjes së këtyre të fundit për lehtësim të sanksioneve kundër Koresë Veriore.
Ministri i Jashtëm kinez, Wang Yi, ka thënë në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara se ShBA-ja duhet t'i lehtësojë sanksionet ndaj Koresë së Veriut.
Rusia ka përkrahur thirrjen e Kinës për t'i rishikuar sanksionet, pas ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov ka thënë se ato nuk duhet të jenë pjesë e "ndëshkimit kolektiv", dhe se sipas tij, tani është koha për të dërguar një sinjal pozitiv te Pheniani për të inkurajuar arritjen e marrëveshjeve. "Hapat e Koresë së Veriut drejt çarmatimit gradual duhet të përcillen me lehtësim të sanksioneve", ka thënë Lavrovi.
Mirëpo sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, i përkrahur nga aleatët perëndimorë, ka kundërshtuar zërat për lehtësim të sanksioneve, duke thënë se këto masa duhet të vazhdojnë të jenë të ashpra derisa Koreja e Veriut të marrë hapa konkretë për braktisjen e armëve bërthamore.



# PRINCËRIT E KULTURËS DHE VALLES SHQIPTARE

Vetëm brenda muajit shtator 2018, Abdyl dhe Fadil Rama-Ramiqi kanë marrë dy çmime tepër të rëndësishme: Në Librazhd "Princ i Artit dhe Kulturës Shqiptare" dhe në Fushë-Kosovë "Dyshi më i mirë"



**Ismet RASHITI**

Nuk është aspak e lehtë të shkruhet për vëllezërit, Abdyl dhe Fadil Rama-Ramiqi nga fshati Pozheran i Vitisë. Ka pesë dekada që veprojnë, ruajnë dhe kultivojnë vallen e bukur tradicionale shqiptare. Nuk ka ngjarje kulturore, festival apo koncert që të mos kenë qenë të pranishëm vëllezërit e njohur Abdyl dhe Fadil Rama-Ramiqi. Shumë mirënjohje, dekorata, çmime dhe falënderime nga bota e kulturës shqiptare. Teksa po shkruaj, nuk kam si të mos ndihem krenar me të arriturat e princërve të valleve, Abdyl dhe Fadil Rama-Ramiqi.

Këtë talent të falur nga Zoti dhe të trashëguar brez pas brezi në këtë familje të madhe dhe të vjetër pozheranase kanë ditur ta mbjellin dhe ta shpërndajnë si nektarin pranveror kudo në trojet shqiptare. Kjo traditë e bukur bashkë me vallet burimore shqiptare ishin ruajtur dhe kultivuar dekada me radhë edhe nga babai i vëllezërve Abdyl e Fadil Rama-Ramiqi, i njohur me emrin Isuf Pozherani.



Edhe ky artist i njohur në të shumtën e rasteve vallëzonte në duet me Rifat Ramën, të njohur kudo si dueti i valleve burimore Isuf e Rifat Rama.

Që në vitin 1970 në Pozheran të Vitisë ishte themeluar SHKA "Përparimi" me kryetar Hamit Alidema.

Që në hapat e parë të saj, pjesë e pandarë ishin e vëllezërit Abdyl dhe Fadil Rama-Ramiqi.

Grupin e valleve e udhëhiqte artisti, Abdyl Rama, ndërsa pjesë e pandarë e tij ishin edhe valltarët e talentuar, Kadri Salihu, Hasan Hasani, Shenasi Shaqiri, Fadil Rama e të tjerë. Fadili ishte njëkohësisht edhe mjeshtër për rrahjen e tupanit gjatë vallëzimeve.

SHKA "Përparimi" ka funksionuar deri në vitin 1983, kur edhe ka pushuar veprimtarinë e saj për shkak të ngjarjeve që ndodhën në Kosovë gjatë vitit 1981 e tutje.

Menjëherë, pas përfundimit të luftës në Kosovë me iniciativën e anëtarëve të saj në krye me Abdyl Ramën, u themelua Ansambli i Këngëve dhe i Valleve Burimore (AKVB) "Dasma" në Pozheran. "Dasma" tashmë ka gjithsejtë 30 anëtarë: burra, gra, vasha dhe djem. AKVB ishte aktive pothuajse në të gjitha festivalet. Pothuaj nuk ka festival që të mos jetë shpërblyer "Dasma" në përgjithësi dhe dy vëllezërit, Abdyl dhe Fadil Rama-Ramiqi.

Në Festivalin "Karadaku 2007, ishte vlerësuar me vendin e parë. Në të njëjtin vit në Gjonaj të Hasit, pas një paraqitje dinjitoze dhe profesionale, Abdyl Rama ishte shpallur valltari më i mirë. Aktiviteti kulturo-artistik i vëllezërve Abdyl dhe Fadil Rama-Ramiqi ishte i pranishëm në të gjitha trevat shqiptare si në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, deri në Turqinë e Sami Frashërit.

Në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës, më 24 deri më 29 shtator 2009, i njohur për traditë, për konkurrencë të madhe dhe juri profesionale, "Dasma" e Pozheranit vlerësohet nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ndërsa, Abdyl Rama merr certifikatë nga Qendra Kombëtare e Veprimeve Folklorike-Bashkia Gjirokastrës. Në këtë Festival së bashku me Abdyl dhe Fadil Ramën kishin përformuar në mënyrë të shkëlqyer artistët: Kadri Salihu, Hasan Hasani, Gjelal Rama, ndërsa nga valltaret, grupi i vashave, ishin Urata Rama, Lavdije Zuka, Labinote Rama, Gentiana Maksuti, Rinore Rama, Ilirjana Zuka, Krenare Salihu, Edona Zuka, Vjosa Zuka e të tjera. Ndërkaq, rapsodët që treguan paraqitje të shkëlqyer ishin: Fadil Zuka dhe Berat Zuka.

Në Festivalin "Revista e Folklorit Burimor Shqiptar" në Drenas, më 25. 09. 2010, Ansambli "Dasma" shpërblehet me Çmim Karriere, vëllezërit Abdyl dhe Fadil Rama-Ramiqi, për interpretim të lartë artistik të valles burimore shqiptare. Për prezantimin e valleve në mënyrë artistike, vëllezërit Abdyl dhe Fadil Rama-Ramiqi, po ashtu u shpërblyen me një varg çmimesh: Me rastin e organizimit të Festivalit Mbarëkombëtar në Librazhd, në tetor të vitit 2010, zunë vendin e parë me vallen "Dyshe të Trashëguar në Breza". Shpërblimi për dy vëllezërit, Abdylin dhe Fadilin ishte me Përkrenaren e Skënderbeut, çmimi për karrierë dhe interpretim të lartë. Sërish në Librazhd në vitin 2011 zënë vendin e dytë.

Po ashtu shpërblehen edhe në Festivalin Ndërkombëtar të Shkup në vitin 2015. Me rastin e shënimit të përvjetorit të rënies së dëshmorit Nijazi Azemi komandant - "Mjekra", manifestim ky tradicional, kulturo-sportiv në Viti, Festivali i Shoqërive dhe Ansambleve Kulturore "Flakadani i Karadakut 2010", Abdyl Rama vlerësohet me çmimin "Valltari më autokton". Pastaj, "Revista e Folklorit Shqiptar-Drenas 2010" vëllezërit Abdyl e Fadil Rama-Ramiqi i nderon me çmimin e "Karrierës për interpretimin e nivelit të lartë të valleve burimore shqiptare". AKVB "Dasma" edhe në Turqi, konkretisht në qytetin e Bursës në vitin 2013, u shpërblye me Mirënjohje. Ansambli Kulturor i Valleve Burimore "Dasma" e Pozheranit ishin në aktivitet artistik edhe më 21 prill të vitit 2018 në Shkodër gjatë ditës, si dhe në mbrëmje edhe në Krujë në manifestimin e fitores së betejës së Gjergj Kastrioti-Skënderbeu së bashku me arbëreshët e Italisë. Aktiviteti i këtyre artistëve të mëdhenj të Anamoravës nuk mundë të përshkruhet përmes një artikulli, meqë është i shumtë dhe i pandalshëm.

Abdyl dhe Fadil Rama-Ramiqi, edhe sot e gjithë ditët merren me kultivimin dhe ruajtjen e valleve burimore shqipe.

Me punën e tyre vetëmohuese dhe angazhimin maksimal profesional, i bëjnë nder artit, kulturës dhe valleve shqiptare në Anamoravë dhe më gjerë në botën shqiptare.






E jashtëzakonshme

## Dubai, dalin në shitje këpucët më të shtrenjta në botë



Harrojini këpucët e kristalta të Hirushes. Këpucët më të kërkuara nga të gjitha gratë në botë janë prej ari dhe me diamante dhe kanë një vlerë prej 17 milionë dollarësh. Me takë të hollë e të lartë, këto këpucë thyejnë edhe rekordin e këpucëve të krijuara nga Debbie Wingham për vajzën e një manjati të Lindjes së Mesme, që u shitën "vetëm" 14 milionë dollarë.

FOTO E DITES



Disa persona të veshur me rroba me ngjyrat e Bashkimit Evropian dhe imazhet e kapitenit të Danimarkës evropiane, Thomas Bjorn, Paris. /AFP/

E rrallë

## Ngjitet mbi 900 metra pa litar në El Capitan



Alex Honnold ka realizuar ëndrrën e tij të madhe. Ai është ngjitur vertikalisht në 'El Capitan', në lartësinë mbi 900 metra pa litar. Atij iu deshën tetë vjet ëndërr, një vit e gjysmë përgatitje dhe një përpjekje e dështuar, për të arritur në majë të formacionit shkëmbor ikonë e të frikshëm El Cap në Yosemite. Përvoja e alpinistit 33-vjeçar do të përcillet me anë të një dokumentari të ri 'Free Solo'. Honnold ngjiti majën e thepisur për 56 minuta.

BARSOLETA E DITËS



**Një prind ia mëson vajzës notin. Të nesërmen vjen pranë pishinës një mik i tij.**
**- Çfarë po bën?, e pyet ai.**
**- Dje ia mësova vajzës notin, ndërsa sot ka dy orë që po rri nën ujë, përgjigjet prindi krenar.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Në ora 16:00**

### "HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation" 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

**Rolet:** Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

**Regjia:** Genndy Tartakovsky







**Në ora 18:00**

### "THE DARKEST MINDS"

Fantastiko-Shkencor/Triller; 1 orë 45 min

**Rolet:** Bradley Whitford, Amandla Stenberg, Mandy Moore, Gwendoline Christie, etj.

**Regjia:** Jennifer Yuh Nelson

**Në ora 20:00 dhe 22:00**

### "THE PREDATOR" 3D,

Aksion/Aventure/Horror; 1 ore 47 min

**Rolet:** Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilera, Jake Busey, etj.

**Regjia:** Shane Black




**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Drejtojuni një personi të familjes sot për të marrë këshilla dhe do të shikoni që çdo gjë që do t'ju thotë do të ketë peshë tek ju.



**DEMI**
Një projekt të ri nuk e keni marrë farë me entuziazëm dhe ata që ju njohin mirë e dinë që nuk do të arrini ta çoni deri në fund.



**BINJAKËT**
Keni ende dilema lidhur me një person dhe nuk do t'i zgjidhni derisa të arrini të diskutoni me një mikun tuaj.



**GAFORRJA**
Nuk keni qenë dhe shumë korrekt me një person afër jush që kërkon më tepër vëmendje nga sa i jepni. Mbase duhet t'i bëni të qartë gjërat.



**LUANI**
Nëse nuk jeni të kënaqur nga faktet e fundit mbase bëni mirë të merrni një pozicion të qartë që gjithkush ta kuptojë mendimin tuaj.



**VIRGJËRESHA**
Mos merrni seriozisht fjalët e një personi që për momentin nuk arrin të arsyetojë ftohtë sepse është mjaft i ndikuar nga emocionet.



**PESHORJA**
Mbase keni ekzagjeruar me pretendimet në ditët e fundit. Sot bëni një hap prapa dhe kërkoni falje te personat që keni prekur.



**AKREPI**
Edhe pse instinkti juaj ju thotë krejt të kundërtën, veprimet që do të ndërmerrni janë të ndjekura nga arsyeja dhe logjika e ftohtë.



**SHIGJETARI**
Sot do ta zgjidhni rrugën më të shkurtër për të zgjidhur punë dhe për të mos pasur tepër shqetësime për vete.



BRICJAPI
Keni sjellë shumë gëzim në jetën e personave të caktuar dhe sot do të jetë dita kur do ta merrni mirënjohjen e tyre.



**UJORI**
Jeni tip i programuar dhe nuk ju pëlqejnë shumë surprizat. Sot do t'ju dalë çdo gjë jashtë kontrollit dhe dikush do t'ju bëjë një surprizë të bukur.



**PESHQIT**
Dita e sotme mund të ketë zhvillime që duhen konsideruar seriozisht nga ju. Nëse neglizhoni gjërat, nuk do të shkojnë mirë.

# Dua Lipa, më e dëgjuara në Spotify



Sukseset e Dua Lipës nuk kanë të ndalur. Këngëtarja kosovare me famë botërore është artistja femër më e dëgjuara në Spotify. Spotify është një nga platformat më të njohura të muzikës. Lajmin e ka bërë me dije vetë këngëtarja në profilin e vet në "Twitter".

# Ryan dhe Claire promovojnë "First Man"



Claire Foy dhe Ryan Gosling janë fotografuar nga paparacët duke dalë nga studiot e "BBC-së në Londër ku ishin, pasi kishin qenë për të dhënë intervistë. Çifti aktrojnë së bashku në filmin "First Man", i cili do të publikohet më 12 tetor. Ryan dhe Claire janë në mes të turneut të tyre mediatik dhe së fundmi u ndalën edhe në Paris për ta promovuar filmin në fjalë.



# Kourtney Kardashian shihet me një djalë që i ngjan ish të dashurit

Paparacët arritën të kapin disa fotografi ku Kourtney Kardashian shihej duke u larguar nga një restorant në West Hollywood, e shoqëruar nga një djalë shumë simpatik. Në fakt, shoqërimi me një djalë simpatik dhe që dukej shumë më i ri se ajo nuk përbën lajm kur flasim për Kourtney Kardashian. Ajo çka është risi dhe e çuditshme është se djali që është në shoqërinë e yllit televiziv ngjan shumë me ish-të dashurin Younes Bendjima.

# Lil Wayne rikthehet me album

Reperi Lil Wayne është rikthyer pas gjashtë vjetësh. Ai në ditëlindjen e tij të 36, të cilën e ka festuar dje, ka publikuar edhe albumin e radhës. "Kjo që do të dëgjoni është ajo në të cilën kam punuar për katër, pesë, gjashtë vjet", ka thënë Lil Wayne. Ai është shprehur shumë i lumtur që më në fund albumi i tij të cilin fansat e kanë pritur nga viti 2013 është publikuar të enjten.





| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Autor: GAZMEND MORINA | RRËNIMI, SHKATËRRIMI | ISH BOKSIERI ...... LIKA | REKRUT NË KOHËN E TURQISË | "T" në mes të dy "E" | NJË NGJYRË | [EPOKA E RE] | BAKËRPUNUESI | ZANORE | NXËNËS I SHKOLLËS SË MESME USHTARAKE (shq.) | GRIMCË MOLEKULARE (sh.pashq.) | HIT NGA GRUPI MUZIKOR "NRG BAND" |
| | | | | | | BANOR I NJË SHTETI SKANDINAV | | | | | | ROSAK / KLUB FUTBOLLI ARGJENTINAS ... LORENZO | | | | | |
| | | | | | | E MBAROVA, E PËRFUNDOVA (krah.) | | | | | | | | KALI I STËRITUR / I THAVE | | | |
| | | | | | | USHQIM QË SHTROHET E HAHET GJATË PIJES | | | | | NISESHTE / KËNGËTARJA ..... TAKE | | | | | | |
| | | | | | | TEATËR NË PRISHTINË | | | | MALLKIMI NGA KISHA / PEZMATIMI I VESHIT | | | | | | | |
| | | | | | | LLOJ AGRUME | | | | | | TEZE / VLERË E MONEDHËS SË NJË SENDI KUNDREJT ARIT | | | | | PRES DEGËT E TEPËRTA TË NJË PEME |
| | | | | | | INDIUM | | | VEÇORIA THELBËSORE E NJË DUKURIE / SHKRONJË GREKE | | | | | | | BASHKËT. / NJË PLANET | |
| | | | | | | BASHKËT. | | KITARË (bised.) / LLOJ PEME E VENDEVE TROPIKALE | | | | | | | "URUGUAI" / MALI MË I LARTË NË TURQI (pashq.) | | |
| [EPOKA E RE] | AKTORJA E FAMSHME SPANJOLLE NË FOTO (shqip.) | NJË PREJ FIGURAVE STILISTIKE | TONELATË | SHALQI | MINDERI I ULËT (vjet.) | FRIKACAKU / NËNË (turq.) | | | | | | | | LLOJ PAPAGALLI / BIZNESMEN | | | |
| KËPUCË TË POSAÇME PËR TË RRËSHQITUR MBI AKULL | | | | | | | PËREMËR PRONOR / POLITIKANI FINLANDEZ ... REHN | | | | ZANORE / DY BASHKËTINGËLLORE | | NËPËR ARA, ARAVE / KËNGËTARI POTOKU (Shq.) | | | | |
| E EMËROVA NË NJË POZITË | | | | | | | | | | KËNGËTARJA AMERIKANE GWEN / FLEGËR | | | | | | | |
| SHKURTABIQI | | | | | | | | | KRYELARTË / SHUFËR E FORTË DHE E GJATË METALIKE | | | | | | | BASHKËT. / MUZIKANTI KRASNIQI | |
| ELI FARA | | | NAIM ISMAJLI / FUTBOLLISTI PORTUGEZ KARVALHO (R. MADRID) | | | ZANORE / BOSHTI | | NOTË MUZIKORE / NJËSIA MONETARE BAZË E SHQIPËRISË | | | DESPOT / QYTET UNIVERSITAR NË ANGLI (shqip.) | | | | | | PIANISTJA ALBERTA |
| KËNGËTARE E NJOHUR SHQIPTARE / FUTBOLLISTI ..... CANA | | | | | ZANORE | | ROKERI KRAVITZ (shqip.) / PAJTUESHMËRI (krah.) | | | | | MJET PËR SITJE (sh.shq.) | | | | | |
| | | | | | SHTRAT PËR TË FJETUR / FËMIJA KUNDREJT PRINDËRVE (turq.) | | | | | | | ISMET SYLEJMANI / ANIJATA | | | "IRLANDA" / I NDESH | | |
| EURO - DEPUTETJA GJERMANE DORIS ... | | | | E GJYMTON / GJË E RRALLË E ME VLERË (Lat.) | | | | | | | | | AKTORI FLLOKO / KRAHINË NË SHQIPËRI | | | | |
| BASHKËT. | | AMBASADORI i SHBA-së në SHQIPËRI ALEKSANDËR / DY ZANORE | | | | | | | MIRË DE (bised.) | ZULMË / MBATHËSE SPORTIVE | | | | BASHKËT. / LLOJ VEPRE MUZIKORE | | SHKRONJA XIX / LAKESË (sh.pashq.) | |
| QË KA TË BËJË ME FSHATARËSINË | | | | | | ZANORE / TROYES | | ANTON PASHKU / FUTBOLLISTI CORDOBA (INTER) | | | FEUDALI QË I NËNSHTROHEJ MBRETIT / BASHKËT. | | | | | | |
| | | | | | | | I PËRZJEVA / KËNGËTAR I FAMSHËM AMERIKAN | | | | | | | | | | LUFTËTARI GJERGJ .... ALIA |
| KATROR / BASHKËT. | | OREGON INSTITUTE TECHNOLOGY / DEM, KA | | | | AFROJ (bised.) / DY BASHKËTINGËLLORE | | | | | TITAN, NITROGJEN / OSMAN (perkdh.) | | | | "KENIA" / DEPARTMENT INDUSTRIAL RELATIONS | | |
| [EPOKA E RE] | BASHKËT. / SHKRONJA TË NJËJTA | | AKTORJA ..... KURTI / VARIOLË | | | | | | KËNGËTARJA PERUANE ... SUMAK / IKER KASILLAS | | | | FUTBOLLISTI FRANCEZ .... RAMI (VALENCIA) / DY BASHKËTINGËLLORE | | | | |
| KAFSHË SHTËPIAKE PËRTYPËSE E IMËT | | | | | AKTORJA ITALIANE BELLUÇI / ZANORE | | | | | | | QYTET NË KOSOVË / ZANORE | | | | | |
| KLUB FUTBOLLI NË KOSOVË | | | | | | NANTES | | ISH PORTIERI SPANJOLL SANTIAGO (VALENCIA) | | | | | | | | | |

# Të qenit mëngjarash, është një disavantazh apo një gjenialitet?




**Disa kuriozitete rreth atyre që preferojnë të përdorin dorën e majtë, midis paragjykimeve dhe dhuratave të veçanta të natyrës.**

Deri pak kohë më parë, ata që shkruanin në shkollë me dorën e majtë u kundërshtuan dhe madje u dënuan: sot njerëzit me dorën e majtë nuk konsiderohen më "të gabuar", por rreth tyre ka ende një maskë misterioze. Nuk është rastësi që e djathta në shumë kultura është përmendur si dora "e mirë".

Sot shpesh mendohet se njerëzit që shkruajnë me dorën e majtë janë më të talentuar sesa me dorën e djathtë: nuk është rastësi që te mëngjarashët përfshihen emra të njohur si Albert Einstein, Leonardo da Vinçi, Ludwig van Beethoven, Napoleon dhe, në kohët e fundme ish-presidenti amerikan Barak Obama, sportistët John McEnroe, Valentino Rossi dhe Michel Platini.

Para së gjithash duhet theksuar se mëngjarashët lindin të tillë: një studim i fundit gjerman zbuloi se dora dominante është afirmuar tashmë në jetën intrauterine dhe kjo "zgjedhje" do të lidhej jo me trurin, ende në stërvitje, por me aktivitetin e gjeneve në kurrizin kurrizor. Sot fenomeni prek rreth 10-13% të popullsisë botërore dhe të dhënat duken të qëndrueshme: pra, evolucioni nuk duket se ka pasur efekte përzgjedhëse mbi këtë karakteristikë, edhe pse largimi dhe persekutimet e kanë bërë jetën të vështirë për njerëzit që përdorin dorën "e gabuar".

Reputacioni i keq i së majtës vjen nga larg, duke filluar nga e njëjta etimologji e fjalës: mëngjarash vjen nga latinishtja "mancus", që do të thotë gjymtoj dhe sugjeron idenë e mungesës së diçkaje, në këtë rast të dorës së djathtë.

Gjithashtu edhe fjalës "majtas" i atribuohet një kuptim negativ, si sinonim i "errësirës" dhe "kërcënuese". Feja luan një rol të rëndësishëm në kuptimin e negativitetit që i atribuohet dorës së majtë dhe në përgjithësi për të gjithë këtë pjesë të trupit. Sipas Kuranit, Muhamedi përdorte vetëm dorën e djathtë për ablutionet (larjet dhe ritualet e shenjta), ndërsa me të majtën lante pjesët intime.

Në botën hebraike dhe të krishterë, e djathta dhe e majta janë të lidhura edhe me sferën e së mirës dhe të së keqes: sipas Shkrimeve, për shembull, në ditën e Gjykimit të Fundit "të mirët" do të gjejnë veten në dorën e djathtë të Krishtit, ndërsa shpirtrat e destinuar për të dënuar do të zbresin në të majtën e tij.

Megjithatë, njerëzit me dorën e majtë shpesh marrin hakmarrjen e tyre në dorën e djathtë, siç dëshmohet nga ushtria e njerëzve të shquar dhe të shkëlqyer, të cilët në histori e kanë përdorur të majtën si një dorë dominante. Ndër emrat më të famshëm dallohen për shembull ato të Bill Gates, Lionel Messit, Marie Curie dhe, duke shkuar prapa në kohë, Wolfgang Amadeus Mozart, Mark Twain dhe Aristoteli.

Shkurtimisht, dora e majtë mund të jetë një shenjë gjeniale, edhe nëse arsyet nuk janë të njohura. Dihet se zgjedhja e dorës dominuese është e lidhur me funksionet kognitive. Studimet e fundit kanë treguar se ata që përdorin kryesisht dorën e majtë paraqesin një zhvillim më të madh të hemisferës së djathtë të trurit, në të cilën banon e ashtuquajtura "inteligjencë hapësinore".

Për më tepër, truri i majtë ka një zhvillim të veçantë të callosum corpus, në të cilin kalojnë lidhjet nervore midis hemisferës së djathtë dhe të majtë. E gjithë kjo sugjeron që njerëzit me dorën e majtë kanë një kapacitet më të madh për të përpunuar informacionin.

Fakti i përdorimit të hemisferës së djathtë më shumë sesa i dorës së djathtë, e bën dorën e majtë më kreative dhe më të predispozuar në artet figurative, pasi aftësitë vizuale janë të vendosura pikërisht në këtë pjesë të trurit. Për të njëjtën arsye, sipas një studimi të Kolegjit Universitar të Londrës, njerëzit me dorën e majtë kanë më shumë inteligjencë verbale.

Lidhja veçanërisht e ngurtë midis hemisferave cerebrale gjithashtu i shtyn ata të reagojnë më shpejt ndaj stimujve dhe për këtë ata kanë avantazh në sporte. Fakti i të qenit i detyruar të jetojë në një botë të projektuar dhe të organizuar për ata që përdorin dorën e djathtë, i bën ata më në fund më fleksibël dhe mutitasking.

Mëngjarashët janë veçanërisht të shkëlqyeshëm në disa fusha të ndryshme, duke përfshirë muzikën dhe matematikën, arkitekturën dhe lojën e shahut.

Në veçanti, një studim i cituar në një artikull të botuar në revistën shkencore "Frontiers in Psychology", theksoi, në një grup studentësh, njerëzit me dorën e majtë kapërcejnë pjesën tjetër të kampionit kur është fjala për zgjidhjen e problemeve matematikore sfiduese, veçanërisht në mesin e adoleshentëve meshkuj, ndërsa ata janë të barabartë me të tjerët në zgjidhjen e problemeve më të thjeshta.

Përkundrazi, të qenit plotësisht i djathtë mund të shoqërohet nga një disavantazh në këtë disiplinë. Megjithatë, duke qenë se shumë njerëz me dorën e djathë paraqesin strukturën e njëjtë të trurit si njerëzit me dorën e majtë, duhet treguar kujdes në përcaktimin e zgjedhjes së dorës dominante si një tregues i gjeniut apo një disavantazh njohës. Shkurtimisht, dora e majtë nuk e humbet halogun e misterit.

Së fundmi, një kuriozitet. Zakoni i vendosjes së unazës së dasmës në gishtin e majtë të dorës ndoshta ka origjinën në Romën e lashtë: qëllimi ishte të hiqte të keqen që lidhet me këtë anë të trupit. Si të themi: dashuria dhe vlera e bizhuterive mund të magjepsë edhe forcat më negative.

*(gazeta-Shqip.com)*

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | EVERTON - FULHAM | GG | HULL - MIDDLESBROUGH | 2 | BROMLEY - HALIFAX | 1 |
|---|---|---|---|---|---|---|

# Vëmendja në Gjilan, paralajmërohet një derbi i jashtëzakonshëm

Gjilani dhe Drita do ta zhvillojnë derbin e radhës të dielën në kuadër të xhiros së shtatë në IPKO Superligën e Kosovës. "Skifterat" dhe "Intelektualët" kanë paralajmëruar spektakël në tribuna, kurse Finsik Papuqi dhe Fidan Gërbeshi paralajmërojnë spektakël dhe rivalitet të madh në fushë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Derbi më i madh në futbollin e Kosovës në mes të Gjilanit dhe Dritë zhvillohet të dielën në orën 15:30. Të dyja skuadrat kanë bërë të gjitha përgatitjet dhe në këtë ndeshje synojnë ta marrin maksimumin e pikëve, derisa edhe tifozët "Skifterat" dhe "Intelektualët", përveç përgatitjeve, kanë gjetur kohë edhe ta thumbojnë njëra-tjetrën. "Intelektualët" e kanë vlerësuar Gjilanin skuadër të pabarabartë për Dritën dhe e kanë akuzuar se e ka "ADN"-në në Serbi, kurse "Skiferat" i kanë quajtur kundërshtarët e tyre nga Gjilani si "minoriteti" i qytetit dhe një tifogrup tashmë i shuar.

Futbollisti nga Peja, Fisnik Papuqi, është shfaqur tejet i matur kur ka folur për ndeshjen ndaj rivalëve të Dritës. Mbrojtësi pejan ka thënë se është mëkat shumë i madh që stadiumi në Gjilan nuk është më i madh, pasi i gjithë qyteti do të ishte i pranishëm në ndeshjen derbi që zhvillohet ditën e diel. "Fillimisht desha t'i falënderoj të gjithë qytetarët e Gjilanit ,'Skifterat' dhe 'Intelektualët', që me një fanatizëm të madh e ruajnë derbin e qytetit. Ky është i vetmi derbi që ka mbetur në shtetin tonë, që sjell një atmosferë shumë të zjarrtë dhe është mëkat se stadiumi nuk është më i madh, se i gjithë qyteti do të ishte aty. Sa i përket ndeshjes, si çdo derbi tjetër, edhe ky është mjaft i vështirë. Ne jemi duke u përgatitur maksimalisht që të dalim me rezultat sa më të mirë, por për rezultat do të ishte mirë t'ia lëmë fushës", ka thënë Papuqi për "Epokën e re". Ndryshe nga



Papuqi, Fidan Gërbeshi i Dritës është treguar më i drejtpërdrejtë lidhur me rezultatin e ndeshjes ndaj Gjilanit. Mbrojtësi shtatlartë për gazetë ka thënë se futbollistët e Dritës do ta japin maksimumin për të shënuar fitore, kurse ka ftuar edhe tifozët "Intelektualët" të jenë në numër sa më të madh në stadium. "Të gjithë e dimë se ky është ndër tre apo katër ekipet më të mëdhenj në Ballkan, prandaj dëshira e futbollistëve për fitore është e madhe. Ne kemi pasur një ngecje, por pas fitores ndaj Prishtinës dhe me një fitore tjetër do të hyjmë në serinë e rezultateve pozitive. Kërkoj nga 'Intelektualët' të jenë në numër sa më të madh për të na përkrahur, kurse maksimumi nga ne nuk do të mungojë", ka thënë Gërbeshi. Të dielën zhvillohet edhe një tjetër ndeshje derbi, ku takohen Prishtina dhe Flamurtari në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 18:45.

### Fitojnë Trepça '89 dhe Drenica

Janë zhvilluar dy ndeshjet e para të javës së shtatë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Trepça '89 dhe Drenica kanë shënuar fitore të rëndësishme para tifozëve të vet. Drenica e mposhti Ballkanin në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj me rezultat 2-1. Golat për kuqezinjtë e Skenderajt i realizuan Uran Shala (autogol) dhe Uka, kurse golin e vetëm për Ballkanin e shënoi Jetmir Topalli. Ndërkaq, në ndeshjen tjetër Trepça '89 e mundi Ferizajn me rezultat 1-0, me golin e shënuar nga Renato Hyshmeri, në sekondat e fundit të pjesës së parë. Ferizajasit që nga minuta e 34-t luajtën me një lojtar më pak në fushë.

# MKRS-ja, dy milionë euro për katër projekte në Rahovec

